

Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **IX-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2023.**

Seanca mbahet më **27.10.2023 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsytimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2023 (ref. drejt.FEZH),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri (fasadimi i objekteve të vjetra në qytet-renovimi i kulmit faza III), (ref. drejt. FEZH),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri (fasadimi i objekteve të vjetra në qytet), (ref. drejt. FEZH),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për transfer të mjeteve (ref. drejt. FEZH)
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarje të mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve të pa paguara lidhur me vërshimet e ndodhura në vitin 2022 (ref. drejt. FEZH),
9. Raportim lidhur me listën e përfitueseve nga mjetet e ndara lidhur me kompensimin e dëmit nga vërshimet e ndodhura në vitin 2022 (ref. Drejt.FEZH),
10. Raportim lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor 2023-2024 (ref.drejt. Arsimit)
11. Raportim lidhur me trajtimin e qeneve endacak (ref. drejt.DSHPE)
12. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 06-36005 2023
Klinë, me 17.10 2023



Kryesuesi,
Fadi Gashi



Na osnovi člana 43, 45 i 47 Zakona 03/L-040 o Lokalnu Samoupravu, člana 47 Statuta Opštine Klina 01-110-1232/2010, člana 5 AU MLS broj 02-2015 o sastancima skupštine opštine i člana 4 pravilnika za rad skupštine i opštinskih komiteta, predsedavajući Skupštine Opštine vrši sledeće:

OBAVEŠTENJE

Pozivaju se članovi Skupštine Opštine Klina i ostali zainteresovani da prisustvuju IX- m redovnom sastanku skupštine za 2023 godinu.

Sastanak se održava 27.10.2023 (Petak), u Sali Skupštine Opštine od 10:00.

U slučaju neprisustvavanja sastanku, molimo vas da se oslonite odredbi člana 39 ZLS.

Predloženi:

DNEVNI RED:

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje i usvajanje preporuka KPF-a,
4. Razmatranje finansiskog izveštaja Januar-Septembar 2023,
5. Razmatranje i davanje saglasnosti na predlog-odluke Direkcije za finansije, privredu i razvoj za povećanje budžeta i izradu novog koda, fasada starih objekata u gradu-renoviranje krova III faza (ref. Odeljenje finansija),
6. Razmatranje i davanje saglasnosti na predlog-odluke Uprave za finansije, privredu i razvoj za povećanje budžeta i izradu novog zakonika, fasada starih zgrada u gradu (ref. Odeljenje finansija),
7. Razmatranje i davanje saglasnosti na predlog-odluku za prenos sredstava (ref. Odeljenje finansija)
8. Razmatranje i davanje saglasnosti na predlog-odluke za dodelu finansijskih sredstava za naknadu neisplaćenih šteta u vezi sa poplavama koje su nastale u 2022. godini (ref. Odeljenje finansija)
9. Informacija o spisku korisnika iz izdvojenih sredstava za naknadu štete od poplava u 2022. (ref. Odeljenje finansija),
10. Obavestjenje o početku nove skolske godine 2023/24 (ref. odeljenje obrazovanja),
11. Informacije op tretiranju psi lualica (ref. odeljenje javnih usluga)
12. Pitanja i odgovori.

01Br. 06-36005 2023
Klina 17.10 2023



Predsedavajući,
Fadil Gashi



Data-Data: 17.10.2023

Për/To/Za :	Asamblenë komunale – z. Fadil Gashi
Nga/From/Od :	Drejtoria për Buxhet e Financa - z.Enver Berisha
Përmes/Through/Preko :	Z. Zenun Elezaj – kryetar i KK- Klinë
Tema/Subjekt/Subjekat:	Kërkesë për transfer dhe rialokim të mjeteve brenda OB
Data :	

Kërkojmë të bëhet :

Transfer i mjeteve brenda OB nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi - 130), fondi burimor 10

- Nga programi **Zyra e kryetarit** (160), nën-programi **Zyra e kryetarit** (16018), kodi funksional (0111) të transferohet nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **1,796.40 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **1,796.40 €**.
- Nga programi **Administrata dhe personeli** (163), nën-programi **Çështjet gjinore** (16518), kodi funksional (0412) të transferohet nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **249.50 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **249.50 €**.
- Nga programi **Inspektimet** (166), nën-programi **Inspektimet** (16635), kodi funksional (0411) të transferohet nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **598.80 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **598.80 €**.
- Nga programi **Buxhet dhe Financa** (175), nën-programi **Buxhetimi** (17518), kodi funksional (0112) të transferohet nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **3,849.14 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **3,849.14€**.
- Nga programi **Zyra komunale për komunitet** (195), nën-programi **Zyra komunale për komunitet dhe kthim** (19590), kodi funksional (1090) të transferohet nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **648.70 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **648.70 €**.

- Nga programi **Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi** (470), nën-programi **Bujqësia** (47018), kodi funksional (0421) të transferohet nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **748.50** € në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **748.50** €.
- Nga programi **Kadastra dhe Gjeodezia** (650), nën-programi **Shërbimet Kadastrale** (65090), kodi funksional (0610) të transferohet nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **998.00** € në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **998.00**€.
- Nga programi **Kultura, Rinia dhe Sportet** (850), nën-programi **Shërbimet Kulturore** (85018), kodi funksional (0820) të transferohet nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **2,220.55** € në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **2,220.55** €.
- Nga programi **Arsim dhe Shkencë** (920), nën-programi **Adminstrata** (92090), kodi funksional (0980) të transferohet nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **7,674.47** € në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **7,674.47** €.

Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Mallëra dhe Shërbime (kodi 130) , fondi burimor 10

- Nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime, fondi 10, në kuadër të programit **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programi **Zjarrëfikësit dhe inspektimet** (18422), kodi funksional (0320), shuma **998.00** € të ri-alokohet në nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **998.00** €.

Faleminderit!



- PËR:** Kuvendin e Komunës së Klinës, Kryesuesin **z. Fadil Gashi**,
Shërbimin për Punë të Kuvendit;
- NGA:** Kryetari i Komunës së Klinës, **z. Zenun Elezaj**; *pe*
- LËNDA:** Kërkesë për futje në rend të ditës për seancën e datës 27.10.2023, miratimin e
Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nder komunal;



I nderuar kryesues,

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Klinës;

Kërkojmë mirëkuptimin tuaj për futjen në rend të ditës për seancën e datës 27.10.2023;

- Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nder komunal të nënshkruar nga kryetari i komunës së Klinës dhe komunës së Skenderajt;

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Klinës më vendimin e datës 22.09.2023 ka miratuar nismën e kryetarit të komunës për të hyre në bashkëpunim nder komunal më Komunën e Skenderajt, sipas të cilit ishte autorizuar kryetari i komunës së Klinës për të filluar konsultimet me kryetarin e komunës së Skenderajt për arritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit, më qellim të realizimit të projektit riasfaltimi i rrugës “Afrim Haliti” ku një pjesë e rrugës që lidh fshatrat e dy komunave gjendet brenda kufijve kadastral të Komunës së Skenderajt.

Pas negociatave dhe konsultimeve të kryetareve të dy komunave është arritur dhe nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit Nder komunal, të cilën marrëveshje **Kërkojmë** nga Kuvendi i Komunës së Klinës që ta miratoj, më qellim të zhvillimit të procedurave për realizimin e projektit.

Shtojcë: Marrëveshja e Bashkëpunimit Nder komunal.

Me respekt,

01Nr. *06-36882*/2023
Klinë, datë 26/10/2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

01-Nr. 401-34693 /2023

Klinë më dt: 04/10 /2023

PËR: Komitetin për Politikë dhe Financa.

PËRMES: Kryetarit të Komunës z. Zenun Elezaj,

NGA : Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim z. Enver Berisha



LËNDA: Kërkesë për hyrjen në rendin e ditës shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për shtim të buxhetit, Kodi I ri për projektin “Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet-renovimi i kulmit-Faza III”

Duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë Planifikimi Urban dhe Mjedisi, nr.401-34514/23, dt.2.10.2023, kërkojmë që të shqyrtohet kërkesa për shtim të buxhetit, Kod I ri projektin “Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet-renovimi i kulmit-Faza III” nga participimi i qytetarëve, shuma prej 7,000.00 euro.

Me respekt!



KUVENDI KOMUNAL KLINË

Më : _____/2023.

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) si dhe nenit 40.paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit Për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 38,60 dhe 61 Ligjit për Financa Publike dhe Pergjegjesit nr 05/L-1007 I ndryshuar dhe plotësuar nr.03/L-048 nenit 7 dhe 8 të Rregullorës Komunale Për Ndarje të Subvencione dhe Transfereve Nr 06-4043/2015 ,nenit 16 paragrafi 8 pika 8.2 i ligjit nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 nenit 92 të Statutit të Komunës, duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim lëshon këtë:

PROPOZIM V E N D I M

PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KRIJIMIN E KODIT TË RI ME PARTICIPIM

1. Aprovohet vendimi për shtim te buxhetit, krijimin e kodit të ri- për "Fasadimi i objekteve të vjetra ë qytet –renovimi i kulmit – Faza III" në shumën prej: **7,000.00 (shtatë mijë)€ - kategoria ekonomike Shpenzimet kapitale.**
2. Projekti i ri mund të krijohet me mjetet nga participimi i qytetarëve bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të komunës dhe komunitetit/qytetareve.
3. Komuna financohet me mjete deri në shumën prej **23,000.00 € nga kategoria ekonomike shpenzimet kapitale, nga kodi i projektit Bashkëfinancim me donatorë (48267), nënprogrami Planifikimi Urban dhe Mjedi (66395), fondi 21, kurse qytetarët kanë participuar me 7,000.00 €, vlera e tërësishme e projektit është 30,000.00 €.**
4. Për zbatimin e vendimit do të kujdeset Kryetari i Komunës, të cilin vendim e zbaton Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.
5. Ky vendim hynë në fuqi ,pas miratimit në Kuvendin e Komunës,sipas (QRK)Nr.06/2023} për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019} Për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe të pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.
Emri i projektit: "Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet–renovimi i kulmit – Faza III".
6. Më Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, MAPL,Ministria e Financave dhe Transfereve, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Shërbimi i Kuvendit dhe një kopje në arkivë.

01-Nr. _____/2023.

Kryetari i Kuvendit

Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

01-Nr. 401-34692 /2023

Klinë më dt: 09.10 /2023

PËR: Komitetin për Politikë dhe Financa.

PËRMES: Kryetarit të Komunës z.Zenun Elezaj,

NGA : Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim z.Enver Berisha

LËNDA: Kërkesë për hyrjen në rendin e ditës shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për shtim të buxhetit, Kodi I ri për projektin "Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet"



Duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë Planifikimi Urban dhe Mjedisi, nr.401-34514/23, dt.2.10.2023, kërkohet që të shqyrtohet kërkesa për shtim të buxhetit, Kod I ri projektin "Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet" nga participimi i qytetarëve, shuma prej 5,000.00 euro.

Me respekt!

Fin



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KUVENDI KOMUNAL KLINË

Më : _____ /2023.

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) si dhe nenit 40.paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit Për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 38,60 dhe 61 Ligjit per Financa Publike dhe Pergjegjesit nr 05/L-1007 I ndryshuar dhe plotesuar nr.03/L-048 nenit 7 dhe 8 të Rregullorës Komunale Për Ndarje të Subvencione dhe Transfereve Nr 06-4043/2015 ,nenit 16 paragrafi 8 pika 8.2 i ligjit nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 nenit 92 të Statutit të Komunës, duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim lëshon këtë:

PROPOZIM V E N D I M

PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KRIJIMIN E KODIT TË RI ME PARTICIPIM

1. Aprovohet vendimi për shtim te buxhetit, krijimin e kodit të ri- për "Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet" në shumën prej: **5,000.00 (pesëmijë)€ - kategoria ekonomike Shpenzimet kapitale.**
2. Projekti i ri mund të krijohet me mjetet nga participimi i qytetarëve bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të komunës dhe komunitetit/qytetareve.
3. Komuna financon me mjete deri në shumën prej **44,444.00 € nga kategoria ekonomike shpenzimet kapitale, nga kodi i projektit Bashkëfinancim me donatorë (48267), nënprogrami Planifikimi Urban dhe Mjedisi(66395), fondi 21, kurse qytetarët kanë participuar me 5,000.00 €, vlera e tërësishme e projektit është 49,444.00 €.**
4. Për zbatimin e vendimit do të kujdeset Kryetari i Komunës, të cilin vendim e zbaton Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.
5. Ky vendim hynë në fuqi ,pas miratimit në Kuvendin e Komunës,sipas (QRK)Nr.06/2023} për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019} Për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe të pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.
Emri i projektit: "**Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet**".
6. Më Vendim njoftohen: Kryetari I Komunës, MAPL,Ministria e Financave dhe Transfereve, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Shërbimi I Kuvendit dhe një kopje në arkivë.

01-Nr. _____ /2023.

Kryetari I Kuvendit

Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Komuna Skenderaj

MARRËVESHJE E BASHKËPUNITIT NDËR KOMUNAL




Palët nënshkruese të marrëveshjes

Komuna e Klinës

dhe

Komuna e Skenderajt



Kanë rënë dakord mbi arritjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndër komunal në fushën e infrastrukturës rrugore, përkatësisht riasfaltimin e një pjese të rrugës nga ana e Komunës së Klinës, lokacioni Jashanicë-Burojë në gjatësi prej rreth 250 m, e cila pjese gjendet në territorin e Komunës së Skenderajt në ngastrat 01229-0 dhe 01233-0 ZK Burojë qe lidhet më rrugën “Afrim Haliti”, në Jashanicë të Klinës.

DUKE KONSIDERUAR, të nevojshme dhe të domosdoshme riasfaltimin e kësaj pjese të rrugës e cila përdoret nga banoret e fshatrave të komunës së Klinës dhe asaj të Skenderajt për qarkullim për në shtëpitë e tyre, përfaqësuesit e të dy komunave janë pajtuar për riasfaltimin e kësaj pjese njëra duke lejuar riasfaltimin në territorin e saj dhe participuar financiarisht, e tjetra duke realizuar, financuar pjesën më të madhe dhe ekzekutuar projektin.

Duke pranuar që pjesëmarrja në një aktivitet të tillë është vullnetare dhe që përfshinë bashkëpunim ndër komunal dypalësh mbi baza të drejta për interesa të përgjithshme publike.

Neni 1

BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje bashkëpunimi mbështetet në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, Ligjit për Bashkëpunimin Ndër komunal, Nr.04/L-010, si dhe Ligjit për Arbitrazhin Nr. 02/L-75.

Neni 2

QËLLIMI

Qëllimi i bashkëpunimit është: krijimi i kushteve më të mira për banoret e fshatrave të Komunës së Klinës dhe asaj të Skenderajt të cilët e frekuentojnë këtë rrugë për vajtje ardhje në shtëpitë e tyre. Qëllimi i marrëveshjes është që të definohen qartë caqet, objektivat dhe përgjegjësitë përkatëse të secilit organ veç e veç.

Neni 3

LËNDA E MARRËVESHJES

Lënda e kësaj marrëveshje është:

Lejimi nga ana Komunës së Skenderajt i riasfaltimit të rrugës së përmendur nga ana e Komunës së Klinës, si dhe participimi më mjete financiare në shumën e përmendur si më poshtë;
Kryerja e të gjitha procedurave të prokurimit si dhe realizimi i projektit behet nga ana e Komunës së Klinës, i cili projekt sipas parallogarive kap shumën rreth 25,000.00 € (njëzetepesëmijë).

Ne këtë projekt komuna e Klinës participon më 20,000.00 € (njëzetmijë), ndërsa Komuna e Skenderajt më 5,000.00 € (pesëmijë), ndërsa në rast të tejkalimit të kësaj shume Komuna e Klinës merr obligimet e mbulimit të tyre.

Neni 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SECILËS PALË TË PËRFSHIRË NË MARRËVESHJE

Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së Klinës.

- Realizimin e procedurave të prokurimit,
- Ndarjen e mjeteve në shumen prej 20,000.00 €;
- Mbikëqyrjen e punimeve në të gjitha fazat deri në finalizimin e tyre;
- Pranimin e punimeve nga ana e komisioneve përkatëse;
- Si dhe ndërmerr veprimet e nevojshme në koordinim më grupin e përbashkët punues.

Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së Skenderajt.

- I Lejon Komunës së Klinës kryerjen e punëve në pjesën e përmendur në territorin e saj;
- Participon më shumen prej 5,000.00 € të cilat mjete derdhen në xhirollogari të Komunës së Klinës;
- Merr përsipër sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e projektit;
- I ofron mbështetje komunës së Klinës sipas kërkesave të saj;
- Merr pjese në Komisionin e pranimin të punimeve;
- Si dhe ndërmerr veprimet e nevojshme në koordinim më grupin e përbashkët punues.

Neni 5

KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

Palët në këtë marrëveshje janë pajtuar për formimin e grupit të përbashkët punues për shqyrtimin e çështjeve të caktuara në zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 5

ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

Ç' do mosmarrëveshje mbi interpretimin, menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim, arbitrazh dhe përmes gjykatës kompetente.

Neni 7

HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit ndër komunal bëhet e plotfuqishme pas vlerësimit të ligjshmërisë së saj nga Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale dhe publikimit të marrëveshjes në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës. Kjo marrëveshje është hartuar në katër (4) kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga dy (2) kopje.

Komuna e Klinës
Kryetari,
Zenun ELEZAJ



Datë ___/___/2023

Komuna e Skenderajt
Kryetari,
Pađil NURA



Datë ___/___/2023



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. _____ 2023

Klinë, dt.

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës mbajtur me datë 22. 09. 2023 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi I Kuvendit z. Fadil Gashi. Pjesëmarrës në mbledhje : Kryetari I Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja, znj. Marqe Selmanaj, drejtorë të drejtorive, media, qytetarë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje për ju anëtarë të Kuvendit, në emër të Kuvendit edhe timin përshëndes kryetarin e Komunës, drejtorë të drejtorive, Policinë e Kosovës, OSBE, Radio Alba, Klina Info, zyrtarë tjerë. Edhe një herë faleminderit për prezencë, me lejoni që para se me kaluar tek rendi i ditës, t`ju informoj që jemi prezentë njëzet e gjashtë anëtarë . Kam konfirmim që Blerta Gashi do të na bashkohet. Mund të procedojmë me mbledhjen e Kuvendit. Paraprakisht unë e kam konfirmimin tanimë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të nënshkruar për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit, Bledar Berisha me zotin Ilir Hoti. Iliri është këtu. Besoj që edhe shkresën e betimit e ka dhe e lus që të ngritët në këmbë dhe ta e lexoi betimin.

z. Ilir Hoti bënë betimin

Kryesuesi I kuvendit vazhdon duke thënë: “Besoi që anëtarët e kuvendit e kanë pranuar rendin e ditës. Bashkë me materialin, besoj që edhe sot e keni pranuar material në adresat e juaja zyrtare, kemi edhe dy kërkesa tjera që i kemi nga kryetari i Komunës shtesë në rend të ditës, njëra është miratimi i Nismës për të hyrë në bashkëpunim ndër komunale me komunën e Skenderajt dhe e dyta është miratimi i propozimit për dhënien shfrytëzim afatshkurtër, të lokaleve në pronësi të Komunës. Janë dy çështje pak më urgjente, është mirë që Kuvend me i proceduar.

Në lidhje me rendin e ditës fjalën e morri z. Zafer Gashi I cili tha se kërkesat tona duhet të trajtohen njëjtë si ajo e kryetarit. Ne me kohë e kemi dërguar, e kemi me kohë dhe nuk ka kurrfarë arsye që sot të mos të jenë në rend të ditës.

“ Unë edhe një herë po e sqaroi se kërkesat e kryetarit janë kërkesa urgjente dhe se kërkesat e juaja kanë ardhur pasi që e kemi shpërndarë ftesën dhe rendin e ditës, dhe asnjëra nuk e ka urgjencën për këtë seancë. Ato do të procedohen për seancën e radhës. “ – tha kryesuesi Gashi.

z. Zafer Gashi: Ju lutem, nëse është fjala për urgjencë, ne mendojmë që po aq urgjente janë edhe kërkesat tona. Ne po shohim që kanë ardhë materiale edhe pas dërgimit të rendit të ditës, ky rend i ditës është shtuar sipas kërkesave dhe materialeve të ndryshme prandaj kjo që thoni nuk qëndron.

z. Esat Raci: Përshëndetje kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam dy çështje rreth rendit të ditës. A ka mundësi sot na jepet informacion, meqenëse ne e kemi info vetëm nëpërmes televizioneve publike dhe portaleve rreth fabrikës së Çimentos. Jemi të njoftuar, siç e thashë, nëpërmes portaleve që një vendim nga Gjykatat Themelore ka ardhë. Cilët janë hapat e më tutjemë të ekzekutivi? Çka do të bahet me lejet e dhëna? Çështja e dytë, në qoftë se s'gaboj në seancën e shkurtit apo të marsit, ne e kemi pranuar një kërkesë nga kategoritë e dalë nga lufta për një shumë të hollave. Vendimi ka qenë unanim, në qoftë se s'gaboj. Vendimi ka qenë unanim që me rishikim të buxhetit, të aprovet kërkesa e kategorive të dalë nga lufta. Çka u bë me atë vendim, pse nuk u realizua?

z. Fadil Gashi, kryesues: Ai vendim i Gjykatës ka të bëjë veç me Kuvendin dhe Gjykatën, me asnjë aktor tjetër s'ka të bëjë. Madje as me kryetarin e Komunës nuk ka të bëjë. E as me Vetëvendosjen hiç se hiç, as me radiot lokale hiç se hiç, as me shoqërinë civile hiç se hiç. Atë vendime e ka marrë ky Kuvend. Kuvendi e ka marrë atë vendim unanimisht.

z. Esta Raci: Absolutisht pajtohem me ty kryesues por në proces e sipër ka mundësi që është bërë shkelje nga ekzekutivi.

Z.Arben Limanaj: Përshëndetje të gjithëve, edhe ne si grup, pajtohem që nëse drejtorja përkatëse ka mundësi sqarimi në lidhje me çështjen që u shtrua mbi fabrikën e Çimentos, nëse drejtori i drejtorisë ka mundësi sqarimi sot, te pyetje përgjigje. meqenëse se kemi miratuara rendin e ditës, unë kërkoj që për seancën e radhës së të marrim një raport nga Drejtorja e Arsimit mbi fillimin e vitit të ri shkollor dhe përgatitjet që janë bërë. Ne të gjithë jemi dëshmitarë të vështirësive që u krijuan me tekstet mësimore nga vendimi i Ministrisë së Arsimit . Kërkojmë që të na sqaron Drejtorja e Arsimit, qoftë formë të raportit, qoftë formë të interpelancës, seancën e radhës, sepse shkollat dhe arsimtarët s'janë pajisë me ditarë të punës akoma.

Kryesuesi I vuri në votim tre pika shtesë dhe me shumicë votash u miratuan. Më pastaj e vuri në votim edhe rendin e ditës me tri propozimet e shtuara dhe me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U miratua.

Pika E 1 E Rendit të Ditës: Arsyetimi I mungesave

Përveç znj. Blerta Gashi e cila do të bashkohet së shpejti në mbledhje , gjithë anëtarët e tjerë janë prezent.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Me 26 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 3 e Rendit të Ditës: Rekomandimet e KPF-së.

Me 26 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim u Miratuan

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit të procesit të konsultimeve publike për draft-buxhetin e Komunës së Klinës për vitin dy mijë e njëzet e katër.

Kryesuesi tha se Ju e keni një raport me organizimet që janë duke i bërë në kuptim të ndërtimit të buxhetit për vitin dy mijë e njëzet e katër, me të gjitha fshatrat, mjediset, shoqëritë civile, kategori të ndryshme, madje të fundit deri kemi mbajtur edhe ne një Komitet për Politikë e Financa jashtë rendit të jashtëzakonshëm për me plotësuar edhe kriterin e fundit rreth i raportit që ju sot e keni përpara. Ne kemi thënë edhe nëpër debate, kemi thënë edhe nëpër takime edhe nëpër mbledhjet tona të rregullta që derisa votohet, mund të diskutohet, mund të debatohet, mund të propozohet gjithçka. Besoj se pjesa dërrmuese, pjesa kryesore e këtij draft buxheti është i ndërtuar nga këto mbledhje e takime me gjithë vlerësimet që i ka marrë prej përfaqësuesve të DEMOS që prej minutave të parë e ka përcjellë rrjedhjen deri në fund,

z. Enver Berisha, drejtor I FEZH: Përshëndetje të gjithëve. Realisht, ashtu siç e parasheh Ligji për Buxhetin dhe Ligji për Financat Publike, ne që nga gjysma e qershorit kemi bërë agjendën tonë për prezantimin e kornizë afatmesme buxhetore, ku përfshihen të gjitha bashkësitë lokale fshatrat veç e veç, dhe ku është debatuar korniza e afatmesme buxhetore për vitin dymijë e njëzet e katër, njëzet e pesë, njëzet e gjashtë, dhe realisht është për t'u vlerësuar edhe prezenca e njerëzve që kanë marrë pjesë në këto debate, por veçmas është për me u vlerësuar kontributi i tyre që kanë dhënë me propozimet e tyre konkrete nëpër të gjitha takimet ku ne i kemi mbajtur. Përmes takimeve nëpër lokalitete që i kemi bërë, ne i kemi thirrur nëpër dëgjime buxhetore të gjitha kategoritë, këtu përfshihen bizneset, OJQ, rinia, gra etj. Domethënë është shfrytëzuar tamam ajo bazë ligjore dhe transparencë që draft buxheti të bëhet në bazë të kërkesave të qytetarëve të komunës sonë.

Pika 5 e Rendi të Ditës: Shqyrtimit dhe miratimi i draft-buxhetit të komunës së Klinës për vitin dy mijë e njëzet e katër.

z. Enver Berisha, drejtor I FEZH: I mora dy draftet, sepse sot ju ka ardhë drafti i fundit, e para tij e keni pas edhe një draft tjetër dhe për kudo që keni dilema dhe që kemi obligime me i shfaq ndryshimet që janë bërë, ne do të jemi këtu me i prezantuar, por ndryshimet kryesisht janë mjaft domethënë simbolike. Janë ndryshime në emërtime, jo ndryshimet që kanë ndodhë në projekte dhe në vlera, përjashto në paga që është një lëvizje shumë e vogël, është me pesëdhjetë euro nëpër drejtori, ose njëqind euro më së shumti. Projektbuxheti për vitin dy mijë e njëzet e katër është planifikuar të jetë 14 milion e 648 mijë e 717 euro. Për vitin 2025 është planifikuar të jetë 15 milion e 405 mijë e 948 euro. Ndërsa planifikimi për vitin 2026, 16 milion e 163 mijë euro, 0.56 euro. Domethënë, këto janë ë parametrat buxhetorë, të cilat caktohen edhe nga niveli qendror. Ndërsa te projektet që ju i keni para vetes për dy mijë e njëzet e katër, ndryshimet janë në emërtime.

Hapet Debat pas prezantimit të drejtorit të financave

z. Zafer Gashi: Ne i kemi përcjell edhe herëve të tjera drafte të tilla të ardhura ndër vite. Edhe ky draft e ka atë kornizë të planifikimeve që ekzekutivi e ka bërë për vitet 2024-2026. Unë dua që ta prezantoj një raport të GAPIT ku mund të themi se ne mund të projektojmë planifikime por punët duhet të jenë në afat dhe cilësore. GAP raporton se nga 63 premtimet e kryetarit të komunës janë plotësuar vetëm 7 premtime. Nëse i shohim performancat sipas drejtorive, arsimit i ka pas 13 premtime vetëm 2 janë plotësuar, Bujqësia zero, kultura zero etj. Kjo do të thotë se deri tash ka

plotësuar vetëm 11.01% të premtimeve dhe deri në afatin e parashikuar nuk do të mund të I përmbush kurrsesi.

Zoti Gashi në vazhdim foli për projektet infrastrukturore në detaje të planifikuara në këtë draft buxhet, kishte vërejtje të tij në lidhje me shumën e ndarë për disa fshatra që sipas tij ishte shumë e vogël. Po ashtu ai u ndal edhe tek uji I pijshëm ku tha se do të ndahen disa mjete por nuk ka garanci se do të kemi ujë të pijshëm. Duhet të ketë kujdes që të përmbushet premtimi I dhënë ndër vite për ujin e pijshëm , tha z. Zafer Gashi.

“Ndarja e buxhetit për vetura , dy vite nga 35 mijë euro , mendoj që kjo ndarje duhet të bëhet më mirë nuk është bërë në mënyrën e drejtë” e përfundoi fjalën e tij z. Gashi.

z. Valmir Bacaj: Këtij draft buxheti I ka paraprij konsultimi me qytetarët, fermerët , shoqëria civile dhe janë përfshi shumë projekte të rëndësishme për qytetarët e Klinës. Organizata prestigjioze DEMOS e ka vlerësuar shumë mirë këtë Projekt buxhet dhe ecurinë deri në përpilimin e tij. Sa I përket raportit të institutit GAP, për hirë të korrektësisë kemi 63 premtime, 7 janë të përfunduara, 43 janë në proces. Nëse e kthejmë në % 63% të premtimeve janë në proces dhe këto premtime do të realizohen gjithsesi sepse janë bërë për një mandat 4 vjeçar dhe jo dy vjet sa jemi deri tani. Janë disa premtime ku kërkohet investim ndërkombëtar dhe askush nuk vjen për të investuar derisa kryeministri ynë vazhdimisht përmend luftën, pra, është zor të mbahen këto premtime.

z. Bacaj në vazhdim foli edhe për rangimin në listën e performancës ku komuna e Klinës është në mesin e 10 komunave me transparencë më të mirën.

z. Zafer Gashi: Është shumë e vërtetë që disa premtime janë në proces por unë u ndala vetëm tek ato që janë të përfunduara.

z. Kushtrim Haliti: Përshëndetje të gjithëve. Në të shumtën e rasteve edhe buxheti është I njëjtë sikurse herëve të kaluara. Për fshatin Jelloc, JAshanice dhe Pogragjë, projektet nuk janë të definuara. JAshanica I ka 7 fshatra, asnjë fshat nuk ka ndriçim, rruga në Gjurgjevik të madh një shi kur bien ata kanë të pamundur që të kalojnë. Një rrugë e keni shtruar atje për dy familje vetëm sepse ata janë votues të Aleancës. Rrugën që keni shtruar bashkë me FSK nëse nuk intervenohet këtë vit do të bëhet e pakalueshme.

z. Haliti foli për rrugët e tjera që janë në gjendje shumë të keqe por që nuk janë definuar në këtë projekt buxhet dhe nuk dihet nëse janë planifikuar të ndërtohen. Gjithnjë duke ju referuar BL JAshanicë.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. Dua ta falënderoj shumë për këtë projekt buxhet të paraparë. Është një buxhet I shpërndarë nëpër të gjitha lagjet dhe fshatrat e komunës së Klinës e në veçanti më vjen mirë për planifikimin e trotuarit Klinë-Krushevë e vogël- Zllakuqan, Faleminderit po ashtu për planifikimin e ndërtimit të kanalit të ujitjes në fshatrat Budisalc, Jagodë, Radulloc, Poterq, Dollovë sepse me këto kanale ujitjes zhvillohet shumë prodhimtaria e bujqësisë.

z. Esat Raci: Na ka ardhë draft buxheti për vitin 2024, e kemi lexuar e analizuar. Me vëmendje të shtuar I kemi shikuar projektet kapitale; cilat projekte planifikohen te realizohen, ku do te realizohen dhe sa do te kushtojnë.

Të gjitha këto projekte të planifikuara janë të nevojshme dhe nëse realizohen sipas kriterëve do të ngritin mirëqenien e qytetarëve gjithsesi, por se kriteret shkelen dhe punët bëhen shkel e shko është e njohur tashmë, jemi dëshmitarë të gjithë veç kush ka ngarkesa politike dhe nuk donë me e pranuar. Kur shkelen kriteret dhe projekti realizohet për të dështuar pas 3 muajve ajo është abuzim me parat e taksapaguesve. Abuzime të tilla ka plot, s`po dua me I përmend cili projekt e ku është punuar keq, atë jua thonë qytetarët çdo ditë dhe ju I dini shumë mirë.

Kërkojmë që të mos I justifikoni dështimet e projekteve, mos I qitni hi syve qytetarëve sepse veç vetën tuaj e mashtroni. Qytetari I sheh dhe I prek çdo ditë. Kërkojmë që një herë e përgjithmonë të kërkohet dhe të mos I bëhet asnjë pagesë punëkryesit pa u pranuar puna e kryer nga komisioni profesional. Kërkojmë nga komisioni I pranimit të jetë korrekt dhe të respektoj ligjin dhe kualitetin e punëve. Kur jemi tek projektet, respektoni rekomandimet e auditorit dhe përmirësohuni.

Grupi Kuvendar I PDK-së, këtu e 6 vjet rresht për çdo draft buxhet ka propozuar projekte të caktuara por asnjëherë nuk kemi gjetur gatishmërinë tek ekzekutivi që të I përfshij ato projekte në buxhetim. Nuk kanë qenë asnjëherë projekte të PDK-së, as për PDK-n por për qytetarë të Komunës të cilën ju e drejtoni. Prandaj kësaj radhe PDK nuk do të propozoj asnjë projekt që të futet në këtë buxhet të planifikuar, por vota e grupit kuvendar të PDK-së do të jetë pro këtij buxheti. Jo Pro ekzekutivit por pro qytetarëve të Klinës pavarësisht nga përkatësia politike, racore e gjinore. Pra, për hatër të qytetarëve të Klinës ne do të votojmë PËR.

Ka shumë projekte të nevojshme që kanë ngelur pa u përfshi në këtë buxhet, ka ngjyrë të theksuar politike kjo ndarje e buxhetit, le të mbetet në ndërgjegjen tuaj duke ua kujtuar se edhe votuesit e PDK-së janë qytetarë të Klinës dhe taksapagues.

z. Arben Limanaj: Përfshirja e projekteve nëpër fshatra dhe lokalitete është relativisht e mirë por ajo që më bënë përshtypje që sa kohë që jam asamblist , propozimet e vogla që nuk kanë shuma të mëdha edhe neglizhohen vazhdimisht pavarësisht që grupi ynë kuvendar asnjë herë nuk ka dështuar në mbështetje të projekteve dhe buxhetit por dy projektet e vogla që ne I kemi propozuar nuk kanë gjetur mbështetje. Është propozimi për sheshin “Ibrahim Rugova” dhe propozimi për një objekt që I takon historisë dhe trashëgimisë kulturore e historike, Shtëpia e kuvendeve në Bokshiq, po e ri përsëris, nuk është objekt që I takon një subjekti politik pasi që këtu janë mbajtur me dhjetëra aktivitete të forumeve të ndryshme. Për këtë vit ka qenë si projekt I llogaritur por nuk ka asnjë procedurë të nisur dhe as projeksione për vitin e ardhshëm që të realizohet. Ajo që më irritoj më së shumti , dje isha në fshatin që përfaqësoi dhe të vetmes familje që e përkrahë pushtetin e tanishëm vetëm asaj I kishin dërguar asfaltin deri te shtëpia ndërsa të tjerëve jo. Janë lënë të gjitha rrugicat e tjera në lagje dhe I shtrohet vetëm asaj familje, Ky është një nënçmim I vazhdueshëm që po an bëhet si asamblistë.

Znj. Valmira Krasniqi: Dëshiroj të pyes për një rrugë afër Lumit “Klina”, e shtruar me zhavorr por që është dëmtuar prap. Nuk ka ndonjë emër lagja, mungon edhe emir I rrugës s`po mundem me jua përshkruar saktë ku është. Aty mungon edhe ndriçimi edhe infrastruktura.

z. Azdren Ramadani: Përsëritje. Pasi jemi tek buxheti dëshiroj që të flas pak për shumën e ndarë 90 mijë euro për gjelbërim. Kërkoj që ajo zonë e qytetit të gjelbërohet nga sheshi “ Nënë Tereza” deri tek QKMF, te dekorohet me drunjtë gjelbërues pasi që vetëm ajo pjesa ka mbetur e tillë.

Znj. Lirie Gashi: Përshëndetje të gjithëve. Dëshiroj të diji për rrugën “ Heronjtë e Kombit” në Dollc a është planifikuar që të ndërtohet. Asaj rruge I mungon kanalizimi, ndriçimi, s`ka trotuar.

z. Enver Gashi: Përshëndetje. Dua të ndalem tek projektet me prioritet dhe mendoj që këto projekte janë të shpërndara mirë dhe në ngritje të mirëqenies qytetare. Duke marr për bazë nevojat e shumta te qytetarëve dua të ndalem tek bashkësia më e madhe që është Sferka, projektet infrastrukturore të shtohet vlere sepse kërkesat e qytetarëve janë të mëdha.

Znj. Besiana Gashi: Të nderuar të pranishëm. Në kuadër të këtyre projekteve kam një kërkesë që të përfshihet edhe fshati Çabiq , pjesa ku nuk ka ndriçim publik.

z. Ndrec Zefaj: Përshëndetje të gjithëve. E kam lexuar dhe analizuar buxhetin për vitin 2024. Dëshiroj te ndalem tek ndërtimi I infrastrukturës mbi dhe nën tokësore në fshatrat Ranoc dhe LEskoc, ndarja buxhetore për këtë rrugë është e vogël dhe nevoja shumë me e madhe pasi që mendoj se kjo rrugë përveç tjerash duhet të shtrohet edhe me një shtresë asfalti.

Z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Përshëndetje të gjithëve. Do të mundohem të përgjigjem në të gjitha shqetësimet e anëtarëve në lidhje me projekt buxhetin. Për ujin e pijshëm këtë vit jemi në tentativë, është hera e tretë që e shpallim tenderin, janë nda 850 mijë euro për ndërtimin e fundërruesit që do ta furnizoj fabrikën ekzistuese e fabrikës duhet të I riparohen filtrat. Vlerat e projekteve që u përmenden , mendoj që me investimet e këtij viti do të përafrohen të gjitha nevojat e qytetarëve për asfaltime dhe kanalizime. Kemi paraparë edhe buxhet shtesë për të ndërtuar rrugica të vogla. Ne kemi përfshi rrugët kryesore duke I emërtuar dhe kemi future edhe segmentet e atyre rrugëve në atë emërtim. Problemi është se rrugët nuk janë pronë komunale dhe po kërkoj nga qytetarët që banorët të sjellin kërkesën që rruga të mos jetë private por komunale. Për vitin e ardhshëm të gjitha këto rrugë janë future nën një emërtim të përgjithshëm. Tani për tani Dresniku është në një situatë jashtëzakonisht të rëndë sa I përket infrastrukturës rrugore por që kanalizimi është një proces të mirë por rrugicat mbesin sfidë edhe për vitin e ardhshëm. Qytetarët kur të bëjnë kërkesa për asfaltime të rrugicave të sjellin edhe certifikatën e pronësisë se është në pronësi të komunës sepse po kemi problem. Jashanica është përfshirë në këtë buxhet që të kompletohet me asfaltime të rrugicave edhe Kërrnica po ashtu. Sheshi “ Ibrahim Rugova” është në kontratë për këtë vit por kemi një shqetësim sepse rrethi është afër hekurudhës dhe nuk kemi mundur të marrim pëlqim për ndërtim të tij. Për shtëpinë në Bokshiq kemi bërë një gabim sepse I kemi emërtuar objekte sportive, këtë vit do ta rregullojmë dhe nuk do të kemi asnjë pengesë që ta rinovojmë atë shtëpi. Tani kemi filluar që rrugët kryesore të ju shtohet edhe shtresa e dytë e asfaltit sepse vetëm një shtresë nuk garanton qëndrueshmëri. Edhe në Resnik, Sferkë, Ranoc e Leskoc, Jelloc etj. kemi planifikuar buxhet për vitin e ardhshëm që të intervenohet në rrugët kryesore. Gjithsesi së bashku edhe me ju do të ju përgjigjemi të gjitha kërkesave të qytetarëve.

z. Zafer Gashi: Nuk po e shoh askund premtimin tënd të dhënë për ndërtimin e një Çerdheje në lagjen “ Dukagjini”. Tani po e shoh që është planifikuar ndërtimi I një Çerdheje afër shkollës “ Motrat Qiriazit”. Për cilën Çerdhe është fjala a po flitet për të njëjtën. Rruga Volljak- Sferkë po thuhet që është e përfunduar por vetëm fillimi është I përfunduar.

z. Zenun Elezaj, Kryetar: Për Çerdhe është e vërtetë që në lagjen “Dukagjini” nuk kemi lokacion. Ka qenë vendimi I ish kryeministrit Haradinaj që na pat dhënë mundësinë e bartjes së pronësisë por më pastaj qeveria tjetër e ka tërheq atë vendim dhe ne jemi detyruar që Çerdhen ta planifikojmë për tek

shkolla “ Motrat Qiriazhi”. Ne kemi buxhet edhe tek mjetet e bartura por kemi aplikuar me tre projekte, Një projekt është ato dy degët e rrugës së Sferkës që kanë ngelur pa rregulluar. Kemi aplikuar edhe me projektin për hyrje të qytetit për ndërtim të trotuarit dhe besoj që këto dy projekte do të mbështeten nga Ministria e zhvillimit rajonal.

z. Ndrec Zefaj: Për ujin e pijshëm që planifikohet ndërtimi i liqenit akumulues, ka qenë një ide e vjetër për fshatrat që janë në kufi me komunën e Istogut që të marrin ujin nga kjo Komunë, a ka lëvizje për aktualizimin e kësaj ideje?

z. Zenun Elezaj, kryetar: Kryeministri Kurti ka themeluar një komision ndërministror dhe ata kanë bërë një raport dhe kanë rekomanduar që të merret uji nga Istogu, Bordi i Hidrodrinit në Pejë janë duke punuar në këtë drejtim. Po ashtu raporti i këtij komisioni ka rekomanduar edhe ndërtimin e liqenit akumulues-fundërruesit, Të forcohen argjinaturat e lumit dhe të ndërtohet një ambient rekreatorë përreth lumit. Nuk është në kompetencë tonën por kemi përkrahje të plotë të bordit të Hidrodrinit dhe presim që të realizohet kërkesa e jonë që uji të merret nga Istogu në 100l/s për fshatrat që i përmende. 100l/s behet fjalë për sezonin e dimrit ndërsa për sezonin e verës parashikohet që të merret më pak ujë por mendoj që do të na mjaftojnë kur e kemi parasysht që shumë shpejt do të finalizohet edhe projekti për furnizim për fshatrat verilindore.

Me 23 vota për, 3 abstenim , asnjë kundër u Miratua

Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Kërkesa e parë , buxheti që është paraparë për pagesën e ndërtimit të sheshit në qytet, ministria nuk e ka pranuar me kodin e vjetër dhe ka kërkuar që të bëhet me kod të ri prandaj e kemi sjellë prap në Kuvend këtë pagesë. Kërkesa është për shtim buxheti për sera, pagesën e serave që është bashkëfinancim. Ndërsa në fund është një rialokim i mjeteve të parapara për rrugën Volljak- Sferkë.

Me 25 vota për, asnjë kundër asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të DKA për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve për institucionet arsimore.

Kryesuesi theksoi se janë dy propozime të ardhura nga DKA, nuk kemi të drejt të propozojmë por duhet vetëm të votojmë për ose kundër.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Përshëndetje të gjithëve . Drejtorja e arsimit duke u bazuar në udhëzimin 151/2020 propozojmë komisionin : Astrit Muhaxherin Dhe Lorenc Culajn, kërkoj që të votohet ky komision.

z. Arben Limanaj: Ne këtë komision e kemi pasur edhe më herët dhe unë personalisht nuk e kam votuar jo se dyshoj në aftësitë e tyre profesionale por sepse vazhdimisht në këto përzgjedhje ka ndikim ekzekutivi dhe them se asnjëherë komuna e Klinës nuk ka pasur drejtor më të dobët në mbi 70% të tyre.

z. Zafer Gashi: Është e vërtetë që edhe herën e kaluar u pat shtyrë votimi pastaj u patën marr vesh dhe u pat votuar. Si është e mundur i njëjti komision me të njëjtin përbërje të intervistoj një kandidat që në një shkollë del i vlerësuar 60% ndërsa për një shkollë tjetër i njëjti kandidatë del i

vlerësuar 84%? Secili kandidat ka konkurruar në më shumë se në një vend. Ka pasur edhe konflikt interesi sepse njëri nga anëtarët e këtij komisioni ka zgjedhur eprorin e vet. Kjo përzgjedhje e drejtorëve është përmëshje e premtimeve elektorale të kryetarit. Një përzgjedhje e tillë nuk shkon në të mirë të performancës së shkollave në komunë. Zgjidhet drejtor një kandidat që pas një apo dy muajve del në pension, Ne do të votojmë kundër këtij propozimi.

z. Kushtrim Haliti: Ne e dimë se në çfarë niveli I kemi shkollat por nuk është mirë që të I lejmë shkollat pa drejtorë prandaj ne si grup e përkrahim këtë komision.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor I DKA: Sa I përket përzgjedhjes së drejtorëve mund të them se s'ka pas asnjëherë përzgjedhje më transparente dhe të mirë, Unë ju uroj atyre që janë zgjedhur.

z. Valmir Bacaj: Kemi pranuar propozimin për komisionin për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, Mendojmë që janë në nivelin e duhur dhe të kërkuar profesionalisht prandaj jemi pro këtij komisioni.

Me 17 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime u MIRATUA.

Pika 8 e Rendit të ditës: Rishqyrtimi I vendimit nr. 06 2208/23 dt. 5. 7. 2023

Kryesuesi tha se duhet të rregullohet baza ligjore e strategjisë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun. Ai tha që ne si kuvend e ndryshojmë vendimin duke u mbështetur në infrastrukturën e re ligjore.

Me 20 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u Miratua rishqyrtimi

Pika 9 e Rendit të Ditës: Kërkesa e kryetarit të komunës për autorizim për marrëveshje me komunën e Skenderajt për asfaltimin e një rruge të përbashkët.

Me 20 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Kërkesa e dytë është që lokalet në pronësi të komunës që janë në shkresë të jepen në shfrytëzim afatshkurtër dhe pastaj të kalohet në formimin e komisionit

z. Zenun Elezaj, kryetar: Ne jemi munduar që të gjitha lokalet që nuk kanë paqartësi ligjore , këto lokale janë tek NOJTRA 20 dhe 3 lokale janë tek shkolla "Ismet Raci". Sot po kërkohet me një procedurë dhe ky proces duhet të monitorohet komplet nga Kuvendi. Këto lokale janë në gjendje të mjerueshme dhe me sado vlerë ti kthejmë në treg.

z. Zafer Gashi tha se është e arsyeshme që të open këto lokale dhe të nisin bizneset por që në të ardhmen të shikohet mundësia edhe për lokale të tjera dhe të shihet padrejtësia që behët nga persona që shfrytëzojnë lokalet njerëz që nuk kanë kontrata me komunë. Ndërsa kryetari theksoi se do të vazhdojnë me qartësimin e situatës së të gjitha lokaleve. Për dhënien në shfrytëzim të këtyre lokaleve me qira ishte dakord edhe z., Valmir Bacaj dhe grupi I tij kuvendar.

Me 25 për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Përzgjedhja e komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme u bë sipas rregullores të cilën e citoi kryesuesi I Kuvendit z. Gashi.

U propozuan: Drilon Morina, Rexhep Gashi, Kushtrim Haliti, Blerina Gashi, Shoqëria civile

Me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA.

Komisioni për ankesa u propozua: Valmira Krasniqi, Luigj Ademi, Kreshnik Raci, Haki Bajraktari, shoqëria civile.

Me 25 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 10 e Rendit të Ditës: Raportimi I drejtorit për ecurinë e fabrikës së çimentos

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Përshëndetje. Sa I përket kësaj pike neve na ka ardhur një shkresë zyrtare nga LVV të cilës do ti referohem por edhe debateve dhe protestave që I kanë bërë të ashtuquajturit grupi kundër fabrikës. Lidhur me shkresën e lartcekur unë nuk kam ndonjë koment pasi që vendimi është marrë nga gjykata themelore në Prishtinë dhe ka të bëjë vetëm me hedhjen poshtë të paditëses, qeveria e Kosovës- MAPL kundër të paditurës, Komuna e Klinës. Ky aktvendim nuk ka të bëjë fare me drejtorinë e Urbanizimit dhe nuk është lëshuar në trajtimin e çështjes.

Drejtori foli në vazhdim në lidhje edhe me aktivitetet e grupit kundër ndërtimit të fabrikës. Drejtori tha se I njoftoj qytetarët se ministria e mjedisit edhe pas anulimit të lejes ka lëshuar leje të ndryshme, leje mjedisore në tre raste për 234 hektar për të njëjtin operator Wallnigford.

z. Zafer Gashi tha se shihet që çdo gjë është bërë jo mirë, ardhja në këtë situatë nuk është e mirë fare. Kemi kërkuar një seancë të jashtëzakonshme që do të merrnin pjesë edhe qytetarët, ju lutem mos I ofendoni qytetarët duke I quajtur Të Ashtuquajtur grupin e tyre sepse është një numër I madh I qytetarëve që kanë nënshkruar peticion. Vendimin e marrur është dashur që ta postoni në web faqe të Komunës , është një dokument I mirë I ardhur dhe është meritë e këtij Kuvendi. Komisioni hetimor nuk arriti asnjëherë që të jap raport para kuvendit dhe unë I bashkohem thirrjes së kryesuesit që të I epet një epilog por unë gjithashtu kërkoj të dijë se çka do të bëhet pas këtij vendimi.

z. Gashi tha se ajo çka sjell ky dokument na bënë neve me mëndu se çka pritet në të ardhmen. Ai pronar I asaj kompanie me siguri që do të kërkoj dëmshpërblim tani pas vendimit të gjykatës themelore. Drejtorja dhe organet e tjera që kanë dhënë leje gjatë kohës sa lënda ka qenë në gjykatë janë ngutur. “ Ne kërkojmë që të konsultoheni me zyrën ligjore dhe ti marrim hapat pararendës që mos të dëmtohet komuna. Kërkojmë gjithashtu që pas këtij vendimi komuna të bëjë tërheqjen e lejeve të dhëna” tha në fund z. Zafer Gashi.

z. Fadil Gashi: Po flas si anëtar I Kuvendit. Sa I përket gjuhës që është pjesë e vendimit të nxjerrë në Kuvend. Vendimi është kthyer në pikën zero tanimë. Në një seancë të kaluar e kemi nxjerr një vendim dhe një komision hetimor I cili komision më ka thirr edhe mua dhe ak marrë deklaratën time. Ku është ajo deklaratë e imja., Është e pasinqertë që nuk implementohet puna e atij komisioni por del me deklarata kryetari I atij komisioni nëpër media e nuk vjen këtu ku është zgjedhur që të raportoj. Nuk është e sinqertë që të del dikush nëpër media nga ai grup dhe të fyej krejt kuvendin dhe krejt punën e kuvendit ta tjetërsoj e ta bëjë të veten. Vendimet e gjykatave nuk interpretohen, Lejes së ndërtimit ju ka paraprij disa pëlqime që I ka dhënë ministria. Këto pëlqime që z, Zafer GASHI mi ka pas kërkuar ja kam dhënë por nuk I ka bërë publike. Tani unë as sot nuk e diji a kemi bërë mirë apo keq që e kemi ndaluar ndërtimin e fabrikës, sepse nuk besoi që dikush është kundër zhvillimit

ekonomik por ky kuvend e ka marrë një vendim. Lehtë është me dalë nëpër media e me folë por ky ekzekutivi ynë , zyra e jonë ligjore 36 prova I ka dërguar në gjykatë, prandaj është marrë ai vendim nga gjykata themelore e kurrresi as shkaku I protestave e as deklaratave të personave nëpër media. Sidoqoftë kryetari I komisionit duhet të vij e të jap llogari këtu në kuvend, kuvend ku është zgjedhur e jo nëpër media, veprimi I tij është I papërgjegjshëm. Mos raportimi I tij në kuvend mund të pasoj kallxim penal për të sepse ka marr deklaratat tona dhe nuk e diji ku I ka dërguar. Sa I përket vendimit dhe fabrikës ne akoma nuk e dimë epilogun.

z. Esat Raci: Kam qenë njeri nga ata që vazhdimisht kam kërkuar që të vijë komisioni dhe të raportoj dhe insistoj përsëri. Le të dorëzohet materiali. Po ashtu e pash të pa arsyeshme drejtorin e urbanizimit që të I quaj të ashtuquajtur ata që protestojnë, kanë të drejt të protestojnë qytetarët. Tani një vendim të gjykatës themelore është, çka do të bëhet me tutje. Vendimi I Kuvendit mbetet në fuqi sipas vendimit të themelores. Çka do të bëhet më tej.

z. Fadil Gashi tha, se aty janë një zingjir dokumentesh e lelesh të dhëna. Nga komuna ka dalë vetëm leja e parë, dokumenti I parë , gjitha të tjerat I ka dhënë ministria përkatëse dhe KPM. Kemi hyrë në transaksione sepse për leje operatori ekonomik ka paguar. Të gjitha këto duhet të zgjidhen përmes gjykatës. Mund të bëjmë gabime kur të bëjmë deklaratat publike prandaj duhet të jemi të kujdesshëm.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Pas vendimit të gjykatës themelore , ne jemi të obliguar që të përcjellim fuqinë e vendimit. Presim konfirmimin e zyrës ligjore se a ka ankesa. Më pastaj ne jemi të obliguar që të marrim veprime që përcaktohen nga ky vendim. Fati I madh është se komuna e Klinës e ka dhënë vetëm lejen e ndërtimit por asnjë investim nuk është bërë në ndërtim. Ne kemi një vendim që e ka pezulluar ndërtimin e fabrikës dhe ju kam thënë edhe qytetarëve se nuk është obligim I tyre me e ndalu ndërtimin fabrikës por imi si kryetar dhe s` ka asnjë diskutim se nuk mund të ndërtohet derisa ka pezullim. Që të jemi pak të kujdesshëm, fabrika e cementit nuk është në rrugë që mund të ndërtohet e komuna e Klinës edhe mund të detyrohet që ta kthej atë taksë që e ka marr nga OE por tjetër gjë nuk besoj sepse nuk është investuar asgjë në ndërtim. Sidoqoftë kur të vije forma e prerë e vendimit do të këshillohem me zyrën ligjore dhe do ta tërheqim lejen e ndërtimit. Në ditët në vijim do ta marrim vesh se a ka bërë ankesë MAPL. Jam I hapur për çdo koordinim.

z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizimit: Asnjëherë nuk kam menduar dhe as nuk mendoj që të fyej qytetarët që protestojnë , i jam referuar vetëm atyre tre katër vetave që kanë dalur para mediave. Kam qenë transparent gjithmonë dhe do të jem.

z. Zafer Gashi kishte vërejtje tek drejtori I urbanizimit për deklaratat e tij për aktivitete e LVV sepse ato janë aktivitete politike të kësaj lëvizje. “ Neve na ka befasuar aq mirë si komision kur e kemi intervistuar z. Fadil Gashi I cili shumë qartë na ka thënë në atë kohë- mos qofsha në lëkuren e atij drejtori” tha në fund z, Gashi.

z. Valmir Bacaj tha se ka qenë insistues që vendimi I gjykatës të sqarohet e mos të I epet hapësirë për keqinterpretim nga individ. Deri tani dihet kush ka qenë fitues- Kuvendi Komunal, ekzekutivi dhe qytetarët. Se çka do të behët me të gjitha ato shkresa të ministrisë që na kanë shantazhuar duke kërcënuar se rrezikojmë për të shkuar në arbitrazh dhe lejeve që ministria I ka dhënë. Sa I përket Komisionit për hetim, ka qenë dakordim I shumicës që kryetar të zgjidhet një nga shoqëria civile, Të gjetura nuk ka pasur, edhe pse LVV në Klinë ka keq informuar qytetarët vazhdimisht.

z. Zafer Gashi tha se është I gatshëm që Valmir Bacajn ta zgjedhim për të raportuar për hetimin e komisionit, të nxjerrët një epilog dhe të mbyllet puna e atij komisioni, nuk është qëllimi im që të përdoret raporti edhe pse unë mendoj që ka shumë të gjetura.

Në lidhje me komisionin hetimor rreth fabrikës së çimentos u diskutua edhe më gjatë sidomos rreth mandatit nga kuvendi që e ka pasur ai komision dhe që akoma nuk e kanë përfunduar përgjegjësinë e marrur. Kryesuesi than ë fund se ky kuvend kërkon vetëm korrektësi nga ky komision. Në këtë temë përveç Kryesuesit z. Fadil Gashi u inkuadruan edhe Ndrec Zefaj si anëtar I komisionit, Zafer Gashi, Valmir Bacaj, Tunë Dedaj, Esat Raci, Kryetari I Komunës, Zenun Elezaj etj.

Pika e 11 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje

z. Esat Raci: Kërkoj që të bëjë sqarimin në lidhje me vendimin e marrë nga ky kuvend për kërkesën për mjetet të ndara për OVL të UCK-së. Kërkoj që ai vendim të implementohet.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Zgjidhja e ekzekutivit për këtë çështje ka qenë që kur të ketë thirrje publike për përkrahje aty të I mbështesim, aty mund ta rrisim përkrahjen për organizatat. Në listë të pagave nuk mund të I fusim. Mbështetja e jonë nuk do të mungon por vetëm me shpallje publike , me projekte.

z. Esat Raci morri prap fjalën duke thënë se e di që nuk ka mundësi për t ë hy në listën e pagave por ata kanë ofruar një model sikurse Komuna e Prishtinës. Dakordimi edhe I kuvendit edhe I ekzekutivit ka qenë por k a mbetur të gjetet forma se si ti ndahen mjetet.

z. Enver Berisha, drejtor I FEZH: Dakordimi I anëtarëve të kuvendit dhe ekzekutivit ka qenë që të bëhet me rishikim të buxhetit, E vërteta ka qenë se qeveria nuk ka leju të bëhet rishikim të buxhetit.

z. Arben Limanaj: Kam një pyetje për drejtorin e urbanizimit. Para disa ditëve sipas përfaqësuesit të lagjes së “Veselmehmetve” të Siqevës, ata kanë bërë një ankesë për një projekt që ka mbetur në gjysmë , kanalizimi të ujërave të zeza, Era e keqe është duke jua bërë të pamundur daljen në oborre të shtëpive.

z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizimit: Po, e vërtetë ata kanë bërë një kërkesë të shkruar dhe unë jua kam kthyer të shkruar, kanë bërë kundër ankesë dhe ju kam thënë se do të jua dërgoj inxhinierët në atë lagje dhe mundësinë e parë do të intervenojmë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Buxheti është I ndarë, kontrata është e nënshkruar por nuk po lejojnë bashkëngjitjen me kanalizimin në Ujmirë. Është duke u diskutuar vetëm për kyçje në lagjen e “Millakve” në Ujmirë. Kemi problem të shumta të kësaj natyre sepse qytetarët nganjëherë nuk po lejojnë të kalon kanalizimi nëpër prona të tyre.

z. Valmira Krasniqi: Dëshiroj të pyes kryetarin se kur e ka ndërmend të përgjigjet në pyetjen që ja kam bërë para tre muajve.

U kërkua që të përsëritet pyetja

Znj. Valmira Krasniqi: A ka pronësi komuna ën lagjen Arbëria.

z. Faruk Smajli, drejtor I Inspektoratit: Në bazë të të gjitha të dhënave lokacioni afër stacionit të policisë ka qenë pyetja, kjo parcelë ka qenë në emër të Milorad Mikic por në vitin 2002 kjo pronë ka kaluar në pronësi të një personi tjetër shqiptar. Disa prona të tjera të komunës janë tre parcelë ku janë ndërtuar por presim vendim të gjykatës dhe zgjidhjen e atij kontesti gjyqësor.

z. Tunë Dedaj: Kam një kërkesë të banorëve të Zajmit dhe Deiqit. Janë tre pengesa në largësi 500 metra, tre polic të shtrirë, ata kërkojnë që të hiqet një.

Znj. Lirie Gashi: Kam një kërkesë për drejtorinë e arsimit. A është gati implementimi i participimit të pagesës me 50% për bartjen e nxënësve.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor I DKA: Po kjo është në procedurë.

Znj. Leonora Dakaj: Dua të ngrit një çështje dhe kërkesë të banorëve të fshatit Caravik për një rrugë që lidhë fshatrat e Klinës, Malishevës dhe Drenasit. Është në gjendje të keqe dhe ka nevojë riparim urgjent. Kjo rrugë i përket Ministrisë së infrastrukturës, rrugë rajonale, është ndërtuar në vitin 2006 ndërsa në vitin 2020 është riparuar por pjesa mbi 2 km asnjëherë nuk është riparuar as nuk është mirëmbajtur as nga ministria as nga komuna e Klinës. Në lidhje me këtë banorët e Caravik kërkojnë që të angazhohet me ministrinë përkatëse që kjo rrugë të rregullohet.

z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizimit: Po është shqetësim me vend, Bashkë me kryetarin kemi qenë tek ministri i infrastrukturës dhe kemi kërkuar që të intervenohet në këtë rrugë por për këtë vit na ka thënë se s' ka buxhet.

z. Zafer Gashi: A kemi të drejtë ne si asamblistë të dimë se sa qytetarë serb marrin ndihma sociale nga QPS. Sa e dimë ne ata as nuk jetojnë këtu në Klinë por vetëm vijnë dhe nënshkruajnë kur të vije koha. Një pyetje tjetër, Kryetari ka pranuar disa herë donatorët që sjellin ndihma. Më ka bërë përshtypje një ndihmë që ka ardhur para pak kohe e që ka sjell mjetet për shërbimin e gjinekologjisë. Fatkeqësisht ne nuk e kemi atë shërbim prandaj ato mjetet është mirë me i dedikuar atje ku ka ashtu shërbimi sepse do të përfundojnë keq. Janë mjetet që kushtojnë shumë. E fundit, kemi një kërkesë nga një qytetar, profesor për një bust të patriotit Ymer Berisha, Derik u ka shkuar përgjigja për këtë kërkesë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Sa i përket numrit të serbëve që marrin social nuk e kam informatën por mendoj që kur të duash mund ta marrësh nga QPS. Sa i përket donacionit në fjalë plotësisht pajtohem me ju që mos të marrim pajisje që nuk an duhen ose që janë afër afatit të skadencës, këtë do ta diskutoj me drejtorin gjithsesi. Sa i përket Bustit të patriotit Ymer Berisha, duhet të futet në planin e zhvillimit komunal sepse duhet të parashihen në PZHK, sidoqoftë vitin e ardhshëm do të rishikohet Harta Zonale dhe aty mund të përfshihet, Kam kërkuar vazhdimisht që të përfshihen vlerat që kemi.

z. Faruk Smajli, drejtor I Inspektoratit: Sa i përket pyetjes së z. Tunë Dedaj. Kemi pasur kërkesë nga qytetarët për policë të shtrirë shkaku i shpejtësisë që zhvillohet në atë pjesë. Komisioni inspektues ka vendosur ashtu dhe përveç z. Tunë Dedaj asnjë ankesë nuk e kam pasur nga banorët. Sa i përket pyetjes së Zafer Gashi për lejet që tha se i lëshon inspektorati, dua të ja kujtoj se inspektorati as nuk lëshon leje pune e as nuk verifikon leje pune.

z. Tunë Dedaj: Më vjen keq por nuk kam folur në emrin tim personal. Jam përfaqësues i banorëve të Zajmit. Nëse dëshiron ti unë mund të jua sjell 200 nënshkrime.

z. Lirie Gashi: Dëshiroj të ndërlidhem me donacionet që I kanë sjellë për gjinekologji, pse të dërgohen diku tjetër derisa janë 50 fshatra të komunës së Klinës që kanë nevojë për atë shërbim.

Në këtë pikë kryesuesi, pasi pa që nuk ka pyetje të tjera nga anëtarët e kuvendit, I shpalli të përfunduara punimet e seancës duke falënderuar ët gjithë për angazhim.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesuesi:

Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

**RAPORT I MENAXHIMIT FINANCIAR I KOMUNËS SË KLINËS PËR
PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2023**

RAPORTI NËNTËMUJOR ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048, MBI
MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

1. Hyrje	3
1.1. Granti Qeveritar.....	3
1.2. Granti i të hyrave vetanake	3
1.3. Të hyrat vetanake të bartura.....	3
1.4. Performanca e shpenzimeve.....	4
2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2023 duke i përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit	5
3. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-shtator 2023 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak	6
3.1. Realizimi i të hyrave për periudhën janar-shtator 2023 sipas muajve	7
4. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-shtator 2023 dhe krahasimi me vitin paraprak	8
4.1. Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-shtator 2023 sipas kategorive ekonomike	9
5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-shtator 2023 - raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxhetore në SIMFK	12

1. Hyrje

Raporti për periudhën janar-shtator 2023 është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK, shpenzimet dhe arkëtimin e të hyrave .

Raport financiar për buxhetin, të hyrat dhe shpenzimet për periudhën janar-shtator 2023 është punuar për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën janar-shtator 2023 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023 duke përfshirë edhe të hyrat nga grantet e brendshme dhe te jashtme është **14,793,483.57 €**, buxheti për këtë periudhë është më i lart për 17.14% se buxheti i vitit 2022.

Gjithsej pagesat kanë shënuar rritje prej 43.15% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ku kontributin më të madh në këtë rritje gjatë kësaj periudhe e ka dhënë kategoria e pagave, shpenzimeve komunale, mallrave dhe shërbimeve, Subvencione dhe transfere dhe shpenzimeve kapitale.

1.1 Granti Qeveritar

Granti Qeveritar është burimi kryesor i financimit të buxhetit komunal, ku pjesëmarrja është 78.99% në vitin 2023 (shuma 11,685,992.74 €). Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 13.10% më i lart.

1.2 Granti I të hyrave vetanake

Buxheti nga të hyrat vetanake të komunës për vitin 2023 është shuma prej 1,373,774.00 € (9.29% e shumës së përgjithshme vjetore) krahasuar me vitin paraprak kanë shënuar rritje prej 28.89 % .

Grumbullimi i të hyrave buxhetore gjatë këtij nëntëmujori kanë arritur shumën prej 1,325,610.26 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak të hyrat tatimore dhe jotatimore kanë shënuar një rritje rreth 16.38% që korrespondon me 186,618.93 € më shumë në krahasuar me nëntëmujorin e vitit paraprak.

1.3 Të hyrat vetanake të bartura

Buxheti nga THV të bartura të vitit 2022 gjatë periudhës janar-shtator 2023 është shuma prej 1,254,064.89 € .

Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit, si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe donacionet e brendshme të bartura, participimet e qytetarëve dhe grante tjera siq janë :

- ❖ **Granti i donatorëve të brendshëm - Participimi i qytetarëve** në shumën prej 31,332.12 €, në raport me vitin paraprak buxheti nga ky grant është **4.64 %** (shuma 1,388.49€) më i lartë se në vitin paraprak. Ndikim në rritjen e këtij granti ka qenë bartja e donacioneve të brendshme në këtë vit shuma 20,082.12 € dhe 11,250.00 € janë të hyra nga donatorët e brendshëm të dedikuara për ndihmë ndaj të prekurve nga vërshimet.
- ❖ **Grante tjera të jashtme - Donacion i jashtëm** në shumën prej 18,341.33 €.
- ❖ **Granti i performancës** në total është shuma prej 776,403.11 €, në periudhën janar-shtator 2023 i kemi të alokuara vetëm mjetet nga **DEMOS** në shumën prej **426,739.48 €**, ndërsa mjetet tjera në shumën prej 349,663.63 € janë zotuar nga MAPL.

1.4 Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore në periudhën janar-shtator 2023 në shumën prej 9,384,532.02 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2022 në shumën prej 6,555,687.31 € janë më të larta për 43.15 % . Ndikim në rritjen e shpenzimeve ka pasur kategoria e shpenzimeve kapitale, shpenzimeve komunale, mallrave dhe shërbimeve.


Buxheti i shpenzuar në periudhën janar-shtator 2023 në shumën prej 9,384,532.02 € është 63.44 % e buxhetit në SIMFK krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për vitin 2023. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 8,300,444.33 € (71.03 % në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake 2023 janë shpenzuar 357,499.15 € (26.02% në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat e bartura janë shpenzuar shuma prej 466,610.05 € (37.21% në raport me buxhetin nga Granti), nga donacioni i jashtëm – Save The Children 3,239.01€ (100% në raport me buxhetin nga donacioni).

Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 9,384,532.02 € nga granti qeveritar janë shpenzuar 88.45% , nga të hyrat vetanake të vitit 2023 janë shpenzuar 3.81%, nga të hyrat e bartura 4.97%, dhe nga Save the Children 0.03 % . Krahasuar me vitin 2022 , shpenzimet për këtë periudhë janë më të larta për 43.15 % .

- ❖ **Shpenzimet për paga dhe medijtë** gjatë këtij nëntëmujori, shënuan shpenzimin prej 5,484,350.92 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 81.07 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqesin një rritje prej 23.45%, apo rreth 1,041,707.74 € më shumë krahasuar me shpenzimet e pagave në periudhën e njëjtë të vitit 2022. Ndikim në këtë rritje të shpenzimit ka pasur hyrja në fuqi Ligji i ri i pagave.
- ❖ **Shpenzimet në mallra dhe shërbime** kanë shënuar një rritje prej 40.92% krahasuar me vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur në 1,174,063.35 €, kjo shumë korrespondon me 65.85% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve gjatë periudhës raportuese, paraqesin një rritje prej 40.92%, apo rreth 340,945.96 € më shumë krahasuar me shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve në periudhën e njëjtë të vitit 2022.
- ❖ **Shpenzimet në komunali**, kanë shënuar rritje prej 43.44% krahasuar me vitin 2022. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur 183,597.71 €, kjo shumë korrespondon me 78.07% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet e komunaleve gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 43.44 % , apo rreth 55,599.80 € më shumë krahasuar me shpenzimet e komunaleve në periudhën e njëjtë të vitit 2022. Ndikim në këtë rritje të shpenzimeve ka qenë borgji i bartur i kësaj kategorie nga viti 2022 dhe rregullimi i infrastrukturës-zgjerimi i ndriqimit public.
- ❖ **Shpenzimet në subvencione dhe transfere**, shënuan shumën prej 223,022.35 € gjatë këtij nëntëmujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 52.31% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Te subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqitet një rënie prej 17.07%, apo rreth 45,912.55€ më pak krahasuar me subvencionet dhe transferet në periudhën e njëjtë të vitit 2022.
- ❖ **Shpenzimet kapitale**. Shpenzimet kapitale arritën shumën prej 2,319,497.71 €, që është 41.54% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet kapitale gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 162.69 % , apo rreth 1,436,503.76 € më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2023 duke përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit


Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023	% në total	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2022	Ndryshimi 2023/2022 në %
Granti qeveritar	11,685,992.74	78.99	10,332,171.68	13.10
Të hyrat vetanake 2023	1,373,774.00	9.29	1,065,865.00	28.89
Të hyrat e bartura	1,254,064.89	8.48	1,196,666.06	4.80
31_Granti I donatorëve të brendshëm	31,332.12	0.21	29,943.63	4.64
32_Granti I donatorëve të jashtme	18,341.33	0.12	-	
46_ Save The Children	3,239.01	0.02	4,078.26	(20.58)
61_Granti I jashtëm (Performancës)	426,739.48	2.88		#DIV/0!
TOTALI	14,793,483.57	100.00	12,628,724.63	17.14



Grafiku 1. Buxheti në SIMFK sipas burimit

2. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-shtator 2023 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

Nr.	KODI EKONOMIK	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Nëntëmujori 2022	%	Nëntëmujori 2023	%	Krahasimi 2023/2022	Ndryshimi 2023/2022
				Ne total		Ne total		ne €
1	40110	TATIMI NË PRONË	342,184.71	29.30	512,111.70	28.43	49.66	169,926.99
2	50001	TAX REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	58,631.50	5.02	63,279.00	3.51	7.93	4,647.50
3	50009	TAX PËR LEJE NDËRTIMI	268,700.98	23.01	265,784.25	14.75	(1.09)	(2,916.73)
4	50013	TAX CERTIFIKATAT E LINDJES	984.00	0.08	605.00	0.03	(38.52)	(379.00)
5	50014	TAX CERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	1.00	0.00	91.00	0.01	9,000.00	90.00
6	50015	TAX CERTIFIKATAT E VDEKJES	578.00	0.05	971.00	0.05	67.99	393.00
7	50016	TAX CERTIFIKATA TJERA	28,513.20	2.44	32,989.00	1.83	15.70	4,475.80
8	50017	TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRYSHME	7,257.00	0.62	4,854.00	0.27	(33.11)	(2,403.00)
9	50019	TAX TJERA ADMINISTRATIVE	1,884.20	0.16	1,605.62	0.09	(14.79)	(278.58)
10	50024	ÇERTIFIKATAT MJEKSORE	-	-	590.00	0.03		590.00
11	50026	TAKSA PER LEGALIZIM	-	-	6,737.99	0.37		6,737.99
12	50029	TAKSA PER USHTRIM TE VEPROMTAR.	56,935.25	4.87	51,095.60	2.84		(5,839.65)
13	50032	TAKSA PER FLETE POSEDUESE	-	-	14,831.00	0.82		14,831.00
14	50103	LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJE	1,039.50	0.09	845.00	0.05	(18.71)	(194.50)
15	50104	GJOBAT NGA INSPEKTORIATI	11,515.00	0.99	11,132.63	0.62	(3.32)	(382.37)
16	50205	LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	6,173.55	0.53	6,113.60	0.34	(0.97)	(59.95)
17	50401	SHITJA E SHERBIMEVE	-		-			
18	50403	TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	-		-			
19	50405	SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	8,627.23		8,669.08			
20	50406	PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	3,000.00	0.26	1,030.00	0.06	(65.67)	(1,970.00)
21	50407	QIRAJA VENDOSJA OBJEKT TREGTAR	8,866.50	0.76	4,171.00	0.23	(52.96)	(4,695.50)
22	50408	QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	15,367.00	1.32	18,373.18	1.02	19.56	3,006.18
23	50409	PARTICIPIM - ARSIMI I MESEM	32,799.00	2.81	37,660.00	2.09	14.82	4,861.00
24	50409	PARTICIPIM - QERDHJA	15,366.31	1.32	19,909.00	1.11	29.56	4,542.69
25	50409	PARTICIPIM - SHENDETSIA	24,182.40	2.07	25,784.50	1.43	6.63	1,602.10
26	50409	DONACIONET E JASHTME	4,078.26	0.35	441,228.49	24.49	10,719.04	437,150.23
27	50504	TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	57,942.00	4.96	41,923.00	2.33		(16,019.00)
28	50504	PARTICIPIM NGA GJEODEZIA	-	-	119.00	0.01		119.00
29	56000	PARTICIPIM I QYTETAREVE	24,861.50	2.13	34,717.92	1.93	39.65	9,856.42
30		GJOBAT NGA TRAFIKU	180,438.00	2,245.65	188,445.11	3,199.41	4.44	8,007.11
31		DENIMET NGA GJYKATA	8,035.00	0.69	5,890.00	0.33	(26.70)	(2,145.00)
		GJITHESEJT:	1,167,961.09	100.00	1,801,556.67	100.00	54.25	633,595.58




Grafiku 2. Të hyrat vetanake sipas viteve

3.1. Realizimi I të hyrave vetanake për periudhën janar-shtator 2023 sipas muajve

r.	KODI EKONOMIK	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Të hyrat janar 2023	Të hyrat shkurt 2023	Të hyrat mars 2023	Të hyrat prill 2023	Të hyrat maj 2023	Të hyrat qershor 2023	Të hyrat korrik 2023	Të hyrat gusht 2023	Të hyrat shtator 2023	Totali I të hyrave janar-shtator 2023
1	40110	Tatimi ne prone	36,517.94	23,727.84	40,184.56	66,061.77	143,432.54	29,531.65	37,147.80	84,157.33	51,350.27	512,111.70
2	50001	Taksa rrugore	6,690.00	5,780.00	6,975.00	4,705.00	6,555.00	7,620.00	7,879.00	9,560.00	7,515.00	63,279.00
3	50009	Urbanizem	1,882.82	74,809.17	36,440.56	15,117.49	4,619.81	15,280.33	86,070.51	18,369.80	13,193.76	265,784.25
4	50013	Çertifikatat e lindjes	32.00	9.00	126.00	20.00	53.00	91.00	70.00	136.00	68.00	605.00
5	50014	Çert. E kurorozimit	-	-	-	40.00	-	50.00	1.00	-	-	91.00
6	50015	Çertifikatat e vdekjes	-	55.00	113.00	-	116.00	123.00	110.00	342.00	112.00	971.00
7	50016	Çertifikatat tjera	3,274.00	2,866.00	3,231.00	2,738.00	4,205.00	3,383.00	4,294.00	5,501.00	3,497.00	32,989.00
8	50017	Te hyrat tjera	372.00	-	464.00	340.00	300.00	592.00	400.00	1,540.00	846.00	4,854.00
9	50019	Taksa administrative	362.60	312.90	147.10	107.41	257.80	93.90	101.90	156.50	65.51	1,605.62
10	50024	Çertifikatat mjeksore	-	-	-	-	72.00	108.00	90.00	176.00	144.00	590.00
11	50026	Takë per legalizim	-	1,447.92	1,474.16	346.07	253.00	-	167.50	2,555.34	494.00	6,737.99
12	50032	Taksë per flet posed.	1,389.00	1,217.00	2,476.00	1,139.00	1,715.00	1,200.00	1,906.00	2,203.00	1,586.00	14,831.00
13	50103	Marimanga	-	345.00	-	-	-	-	-	-	500.00	845.00
14	50104	Denimet mandatore	5,500.00	150.00	2,442.23	230.00	115.00	1,200.00	415.40	650.00	430.00	11,132.63
15	50205	Komisioni inspektues	233.00	465.00	928.50	80.00	1,345.00	218.00	640.00	100.00	2,104.10	6,113.60
16	50029	Taksa nga licensa	4,040.00	4,660.00	9,740.00	5,760.00	9,817.50	4,633.10	3,155.00	6,820.00	2,470.00	51,095.60
17	50401	Shitja e sherbimeve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
18	50403	Shitja e pasurise	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
19	50405	Shfryt.pron.publike	1,383.03	150.00	1,260.00	50.00	800.00	1,692.02	2,209.03	1,125.00	-	8,669.08

20	50406	Qer. per treg te hapur	-	-	-		1,030.00	-	-	-	-	1,030.00
21	50407	Qeraja e lokaleve	290.00	100.00	291.00	500.00	869.00	591.00	300.00	1,130.00	100.00	4,171.00
22	50408	Qeraja per banim	615.00	2,683.10	4,819.96	2,335.00	2,145.68	1,323.88	762.88	1,347.14	2,340.54	18,373.18
23	50409	Participim - shendetsi	3,536.50	3,101.50	3,141.50	2,053.00	2,129.50	2,784.00	2,245.50	4,097.00	2,696.00	25,784.50
24	50409	Participim - qerdhja	2,553.00	2,603.00	2,604.00	2,873.00	2,703.00	2,502.00	1,557.00	-	2,514.00	19,909.00
25	50409	Participim - shp. F.A.	50.00	2,410.00	15,820.00	1,460.00	1,000.00	550.00	970.00	420.00	14,980.00	37,660.00
26	50409	Participim nga gjeod.	9.00	18.00	12.00	39.00	16.00	8.00	11.00	6.00	-	119.00
27	50409	Donacion I jashtem	2,110.50	10,650.00	426,739.48		1,728.51	-	-	-	-	441,228.49
28	50504	Kadaster & gjeodezi	3,010.00	3,786.00	7,092.00	4,575.00	5,368.00	3,904.00	2,368.00	5,830.00	5,990.00	41,923.00
29	56000	Participim I qytetareve	-	-	-	14,520.00	-	-	-	13,197.92	7,000.00	34,717.92
30		Gjobat nga trafiku	28,500.00	27,465.00	36,823.00	27,865.00	36,471.11	31,321.00				188,445.11
31		Gjobat nga gjykata	1,365.00	430.00	1,470.00	350.00	1,125.00	1,150.00				5,890.00
TOTALI			103,715.39	169,241.43	604,815.05	153,304.74	228,242.45	109,949.88	152,871.52	159,420.03	119,996.18	1,801,556.67

Tab.3. Të hyeat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-shtator 2023 sipas muajve




Grafiku 3. Të hyrat sipas muajve

4. Shpenzimet buxhetor për periudhën janar-shtator 2023 dhe krahasimi me vitin paraprak

Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023	% në total	Buxheti i shpenzuar janar-shtator 2023	Progresi ndaj buxhetit në %	% në totale shpenzimeve janar-shtator 2023	Buxheti i shpenzuar janar-shtator 2022	Krahasimi i shpenz. 2023 me 2022 në %
Granti qeveritar	11,685,992.74	78.99	8,300,444.33	71.03	88.45	6,252,607.18	32.75
Të hyrat vetanake 2023	1,373,774.00	9.29	357,499.15	26.02	3.81	182,657.31	95.72
Të hyrat e bartura	1,254,064.89	8.48	466,610.05	37.21	4.97	94,983.06	391.26
31_Granti I donatorëve të brendshëm	31,332.12	0.21	-	-	-	21,361.50	(100.00)
32_Granti I donatorëve të jashtëm	18,341.33	0.12	-	-	-		
46_Save The Children	3,239.01	0.02	3,239.01	100.00	0.03	4,078.26	(20.58)
61_Granti I jashtëm (Performancës)	426,739.48	2.88	256,739.48		2.74		
TOTALI	14,793,483.57	100.00	9,384,532.02	63.44	100.00	6,555,687.31	43.15

Tab.4. Shpenzimet buxhetore janar-shtator 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar




Grafiku 4. Shpenzimet buxhetore janar-shtator 2023 krahasuar me periudhën enjëjtë të vitit të kaluar

4.1. Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-shtator 2023 sipas kategorive ekonomike

Përshkrimi	Buxheti në SIMFK 2023	Shpenzimet janar-shtator 2023	Progresi ndaj buxhetit në %	% në total e shpenz. janar-shtator 2023	Shpenzimet janar-shtator 2022	Krahasimi 2023 me 2022 në %
Paga dhe mëditje	6,765,098.74	5,484,350.90	81.07	58.44	4,442,643.16	23.45
Mallra dhe shërbime	1,782,811.89	1,174,063.35	65.85	12.51	833,117.39	40.92
Shërbime komunale	235,183.50	183,597.71	78.07	1.96	127,997.91	43.44
Subvencione dhe transf.	426,353.81	223,022.35	52.31	2.38	268,934.90	-17.07
Kapitalet	5,584,035.63	2,319,497.71	41.54	24.72	882,993.95	162.69
TOTALI	14,793,483.57	9,384,532.02	63.44	100	6,555,687.31	43.15

Tab. 4.1. Shpenzimet buxhetore janar-shtator 2023 sipas kategorive ekonomike



Grafiku. 4.1. Shpenzimet buxhetore janar-shtator 2023 sipas kategorive ekonomike

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – shtator 2023 në shumën prej 9,384,532.02€:

- Për paga dhe medijtje janë shpenzuar 5,484,350.90 € (81.07 % në raport me buxhetin e alokuar për paga)
- Për mallra e shërbime janë shpenzuar 1,174,063.35 € (65.85 % në raport me buxhetin e alokuar për mallra e shërbime)
- Për shërbime komunale janë shpenzuar 183,597.71€ (78.07% në raport me buxhetin e alokuar për shërbime komunale)
- Për subvencione janë shpenzuar 223,022.35 € (52.31 % në raport me buxhetin e alokuar për subvencione) dhe
- Për shpenzime kapitale 2,319,497.71 € (41.54% në raport me buxhetin e alokuar për shpenzime kapitale).

Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 9,384,532.02€, për paga e medijtje janë 58.44 % e shpenzimeve, për mallra dhe shërbime 12.51 % e shpenzimeve, për shërbime komunale 1.96% e shpenzimeve, për subvencione 2.38 % e shpenzimeve dhe për kapitale 24.72 % e shpenzimeve.

Shpenzimet në periudhën janar-shtator 2023 në shumën prej 9,384,532.02€ krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2022 në shumën prej 6,555,687.31 € janë më të larta për 43.15 % . Shpenzimet për paga dhe medijtje krahasuar me vitin paraprak janë më të larta për 23.45%, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë më të larta për 40.92%, shpenzimet për shërbime komunale janë më të larta për 43.44 %, shpenzimet për subvencione janë më të ulëta për 17.07 % dhe shpenzimet kapitale janë më të larta për 162.69 %.

Kodi ekonomik	Përshkrimi	Shpenzimet janar-shtator /2023	Shpenzimet janar-shtator/2022	Ndryshimi
11110	PAGAT NETO PERMES LISTAVE	4.643.010.71	3.753.809.51	889.201.20
11115	PAGESA PËR SINDIKATË	9.498.89	18.622.30	(9.123.41)
11125	ANTARSIM-ODA E INFERMIERVE TE KOS.	1.770.79	1.791.06	(20.27)
11126	ANTARSIM-ODA E MJEKVE TE KOSOVËS	1.120.00	1.920.00	(800.00)
11400	PUNT. ME KONTRATË (JO NE LISTEë Të Të PAG.)	2.770.65	3.513.42	(742.77)
11500	TATIMI NE TARDHURA PERSONALE	304.724.61	227.320.58	77.404.03
11600	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNETORI	260.205.47	206.936.27	53.269.20
11700	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNEDHENSI	260.205.47	206.936.27	53.269.20
11900	PAGESA PËR VENDIME GJYQËSORË	1.044.31	21.793.75	(20.749.44)
TOTAL: 11	RROGAT DHE PAGAT	5.484.350.90	4.442.643.16	1.041.707.74
13130	SHPEN.UDHTIMIT BRENDA	36.971.93	25.811.80	11.160.13
13141	SHPEN.UDHTIMIT JASHT VENDIT- medijtjet	1.190.00		1.190.00

13142	AKOMODIMI - UDHËTIMET ZYRTARE JASHTË VEND	443.94		443.94
13143	SHPENZIMET TJERA TË UDHËTIMEVE ZYRTARE JASHTË VENDIT	231.09		231.09
13310	SHPENZ. PËR INTERNET	1.965.12	2.036.17	(71.05)
13320	SHPENZ.E TELEFONIT-VALA 900	9.568.05	8.353.79	1.214.26
13330	SHPENZIMET POSTARE	7.977.65	6.984.22	993.43
13430	SHËRBIME TË NDRYSHME SHËNDETËSORE	144.628.20	16.00	144.612.20
13440	SHERBIME TE NDRYSHME INTELEKTUALE DHE KESHILLDHENESE	-	150.00	(150.00)
13450	SHËRBIME SHYTYPJE - JO MARKETING	11.501.05	13.674.94	(2.173.89)
13460	SHERB.KONTRAKTUESE TJERA	213.013.75	259.752.08	(46.738.33)
13470	SHERBIMET TEKNIKE	800.00	800.00	-
13480	SHPENZIMET PËR ANTARËSIM	10.617.00	8.836.80	1.780.20
13490	SHERBIMET E VARRIMIT	1.205.00	1.420.00	(215.00)
13501	MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	12.765.00	8.600.62	4.164.38
13503	KOMPJUTER ME PAK SE 1000 EURO	22.311.79	14.659.50	7.652.29
13506	PAJISJE SPECIALISTIKE MJEKËSORE <1000	-		-
13507	PAJISJE TË SHËRBIMEVE POLICOR	23.440.00		23.440.00
13509	PAISJE TJERA<1000 EURO	21.236.49	26.796.37	(5.559.88)
13510	BLERJA E LIBRAVE DHE VEPRAVE ARTISTIKE	-	2.999.00	(2.999.00)
13610	FURNIZIME PERZYRE	22.765.46	21.527.06	1.238.40
13616	FURNIZIM ME ARTIKUJ BUJQËSOR	-	278.50	(278.50)
13620	FURNIZIM USHQIM&PIJE(JO DREKA)	95.535.31	54.969.15	40.566.16
13630	FURNIZIME MJEKSORE	59.442.71	48.874.91	10.567.80
13640	FURNIZIM PASTRIMI	7.700.96	9.460.77	(1.759.81)
13650	FURNIZIM ME VESHMBATHJE	901.00		901.00
13710	VAJ	-		-
13720	NAFT PER NGROHJE QENDRORE	3.839.10	23.093.21	(19.254.11)
13750	QYMYUR	4.638.66		4.638.66
13760	DRU	64.260.84	62.136.55	2.124.29
13770	DERIVATE PER GJENERATOR	1.637.79	842.85	794.94
13780	KARBURANTE PER VETURA	37.807.29	48.204.89	(10.397.60)
13810	AVANC PËR PARA TE IMËT(PETTY CASH)	1.000.00		1.000.00

13820	AVANC PËR UDHËTIME ZYRTARE	-	946.40	(946.40)
13920	PROVIZIONI BANKAR I BKT	-	30.00	(30.00)
13950	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE	2.000.00	1.850.00	150.00
13951	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE	4.586.93	4.254.64	332.29
13953	SIGURIMI I NDËRTESAVE TJERA	1.260.24		1.260.24
14010	MIRM.RIPARIMI I AUTOMJETEVE	21.168.12	15.144.72	6.023.40
14020	MIRMBAJTJA E NDERTESAVE	8.020.65	3.617.71	4.402.94
14023	MIRMBAJTJA E SHKOLLAVE	41.550.62	17.960.79	23.589.83
14024	MIRËMBAJTJA OBJEKTEVE SHËNDETËSORE	4.168.50	983.00	3.185.50
14032	MIRËMBAJTJA AUTO RRUGËVE LOKALE	212.363.65	61.831.27	150.532.38
14040	MIRËMBAJTJA E TEKNOLO. INFORMATIVE	1.475.00	462.63	1.012.37
14050	MIRMB.PAISJEVE DHE MOBILEVE	31.190.80	21.041.40	10.149.40
14060	MIREMBAJTJA RUTINORE	16.948.05	21.276.05	(4.328.00)
14120	QIRAJA PËR TOKË	1.294.00		1.294.00
14210	REKLAMAT DHE KONKURSET	2.100.00	1.400.00	700.00
14230	SHPENZ.PER INFORMIM PUBLIK	3.743.00		3.743.00
14310	DREKAT ZYRTARE	2.468.21	1.664.70	803.51
14410	SHPENZIME-VENDIMET E GJYKATAVE	330.40	30.374.90	(30.044.50)
TOTALI: 13	MALLRA DHE SHERBIME	1.174.063.35	833.117.39	340.945.96
13210	RRYMA	113.411.67	98.110.38	15.301.29
13220	UJI	10.890.95	9.884.69	1.006.26
13230	MBETURINAT	55.574.04	17.913.55	37.660.49
13250	SHPENZIMET TELEFONIKE	3.721.05	2.089.29	1.631.76
TOTALI: 14	SHPENZIMET KOMUNALE	183.597.71	127.997.91	55.599.80
21110	SUB. PER ENTITETE PUBLIKE	500.00	800.00	(300.00)
21200	SUB.PER ENTITETET JOPUBLIKE	222.522.35	268.134.90	(45.612.55)
TOTALI: 20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	223.022.35	268.934.90	(45.912.55)
31120	NDERT. E ADMIN. AFARISTE	127.757.00	16.398.36	111.358.64
31121	OBJEKTET ARSIMORE	14.312.34	16.044.00	(1.731.66)
31123	OBJEKTET KULTURORE	3.473.00		3.473.00
31124	OBJEKTET SPORTIVE		10.868.00	(10.868.00)

31129	FUSHAT SPORTIVE			-
31230	NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE	1.676.744.17	522.459.01	1.154.285.16
31240	TROTUARET	150.000.00		150.000.00
31250	KANALIZIMI	76.928.98	74.396.09	2.532.89
31260	UJËSJELLËSI	27.452.50	21.000.00	6.452.50
31270	MIREMBAJTJA INVESTIVE	13.268.60	80.847.53	(67.578.93)
31510	FURNIZIMI ME RRYMË GJENRATOR TRAFNS	70.000.00		70.000.00
31520	MOBILJE		19.992.00	(19.992.00)
31660	PAJISJE SPECIALE MJEKËSORE			-
31690	PAJISJE TJERA			-
32000	INVESTIMET NË VIJIM		96.586.84	(96.586.84)
32110	RREGULLIMI I LUMEJVE		11.082.90	(11.082.90)
32111	SISTEMI I UJITJES	68.828.52	3.819.22	65.009.30
32120	PARQET NACIONALE	33.174.00		33.174.00
33200	TRANSFERE KAPITALE – ETNITETE JO PUBLIKE		9.500.00	(9.500.00)
34000	PAGESA - VENDIME GJYQËSORE	57.558.60		57.558.60
TOTALI: 30	PASURIT JO FINANCIARE	2.319.497.71	882.993.95	1.436.503.76
	TOTALI I PERGJITHSHEM:11,13,14,20,30	9.384.532.02	6.555.687.31	2.828.844.71



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-36631 /23

Klinë: 24.10.2023

PËR: Kuvendin e Komunës Klinë

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi



REKOMANDIMET e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës: 13.10.2023

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e X për vitin 2023, përveç pikave të parapara në rend dite, shqyrtoi dhe miratoi për shqyrtim në kuvend këto pika:

-Propozim-vendimin nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për transfer të mjeteve financiare.

-Propozim-vendimin për ndarje të mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve, pjesës të cilës nuk i është paguar dëmi nga vërshimet e ndodhura në vitin 2022.

Pika 1. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2023.

-Sa i përket kësaj pike, referoi drejtori për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, z. Enver Berisha, i cili theksoi se, raporti për periudhën janar-shtator 2023 është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Buxheti sipas SIMFK për vitin 2023, duke përfshirë edhe të hyrat nga grantet e brendshme dhe të jashtme është 14,793,483.57 €, buxheti për këtë periudhë është më i lart për 17.14% se buxheti i vitit 2022. Granti Qeveritar është burimi kryesor i financimit të buxhetit komunal, ku pjesëmarrja është 78.99% në vitin 2023 (shuma 11,685,992.74 €). Në raport me vitin paraprak, buxheti nga GQ është 13.10% më i lart. Buxheti nga të hyrat vetanake të komunës për vitin 2023 është shuma prej 1,373,774.00 € (9.29% e shumës së përgjithshme vjetore) krahasuar me vitin paraprak kanë shënuar rritje prej 28.89% .

Grumbullimi i të hyrave buxhetore gjatë këtij nëntëmujori ka arritur shumën prej 1,325,610.26 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, të hyrat tatimore dhe jo tatimore kanë shënuar një rritje rreth 16.38% që korrespondon me 186,618.93 € më shumë në krahasuar me nëntëmujorin e vitit paraprak.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2023, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që raporti të kalojë për shqyrtim në kuvend.

Pika 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri, fasadimi i objekteve të vjetra në qytet-renovimi i kulmit, faza III.

Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, kërkoi që të aprovohet vendimi për shtim të buxhetit, krijimin e kodit të ri- për “Fasadimin e objekteve të vjetra në qytet –renovimi i kulmit, Faza III” në shumën prej 7,000.00 (shtatëmijë)€ - kategoria ekonomike, shpenzimet kapitale. Projekti i ri do të krijohet me mjetet nga participimi i qytetarëve, bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të komunës dhe komunitetit, ky projekt i ri “Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet –renovimi i kulmit – Faza III” mbulohet nga mjetet e participimit me qytetarë, shuma 7,000.00 € dhe pjesa tjetër do të mbulohet nga komuna, nga kategoria ekonomike- Shpenzimet kapitale te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisor, kod i programit (66395).

Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që propozim-vendimi për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri për renovimin e kulmit, të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 3. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri, fasadimi i objekteve të vjetra në qytet.

Nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, kërkuan që të aprovohet propozim-vendimi për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri- “Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet” në shumën prej 5,000.00 (pesëmijë)€, kategoria ekonomike-Shpenzimet kapitale, Projekti i ri do të krijohet me mjetet nga participimi i qytetarëve bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të komunës dhe qytetarëve. Projekti i ri “Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet” mbulohet nga mjetet e participimit me qytetarë 5,000.00 € dhe pjesa tjetër do të mbulohet nga komuna nga kategorinë ekonomike - Shpenzimet kapitale te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisor, kod i programit (66395).

Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që propozim-vendimi për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri për fasadimin e objekteve të vjetra në qytet, të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i propozim-vendimit nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për transfer të mjeteve financiare.

Nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, kërkuan që të aprovohet propozim-vendimi për transfer i mjeteve brenda OB, nga kategoria ekonomike -Mallra dhe shërbime, (kodi - 130),fondi burimor 10.

-Nga programi **Zyra e kryetarit** (160), nën-programi **Zyra e kryetarit** (16018), kod funksional (0111) të transferohet nga kategoria ekonomike - Mallra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **1,800.00 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike -Mallra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **1,800.00 €**.

-Nga programi **Administrata dhe personeli** (163), nën-programi **Çështjet gjinore** (16518), kod funksional (0412) të transferohet nga kategoria ekonomike- Mallra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **250.00 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike -Mallra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **250.00 €**.

-Nga programi **Inspektimet** (166), nën-programi **Inspektimet** (16635), kod funksional (0411) të transferohet nga kategoria ekonomike -Mallra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **600.00 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike- Mallra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **600.00 €**.

-Nga programi **Buxhet dhe Financa** (175), nën-programi **Buxhetimi** (17518), kod funksional (0112) të transferohet nga kategoria ekonomike- Mallra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **3,856.85.00 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike -Mallra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **3,856.85 €**.

-Nga programi **Zyra komunale për komunitet** (195), nën-programi **Zyra komunale për komunitet dhe kthim** (19590), kod funksional (1090) të transferohet nga kategoria ekonomike Mallra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **650.00 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike -Mallra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **650.00 €**.

-Nga programi **Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi** (470), nën-programi **Bujqësia** (47018), kod funksional (0421) të transferohet nga kategoria ekonomike- Mallra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **750.00 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike -Mallra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **750.00 €**.

-Nga programi **Kadastra dhe Gjeodezia** (650), nën-programi **Shërbimet Kadastrale** (65090), kod funksional (0610) të transferohet nga kategoria ekonomike -Mallra dhe shërbime (kodi-130),fondi 10, shuma prej **1,000.00 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike- Mallra dhe shërbime (kodi-130), fondi 10, shuma **1,000.00 €**.

-Nga programi **Kultura, Rinia dhe Sportet** (850), nën-programi **Shërbimet Kulturore** (85018), kodi funksional (0820) të transferohet nga kategoria ekonomike- **Mallra dhe shërbime** (kodi-130),fondi 10, shuma prej **2,225.00 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike -**Mallra dhe shërbime** (kodi-130), fondi 10, shuma **2,225.00 €**.
 -Nga programi **Arsim dhe Shkencë** (920), nën-programi **Administrata** (92090), kodi funksional (0980) të transferohet nga kategoria ekonomike- **Mallra dhe shërbime** (kodi-130),fondi 10, shuma prej **7,689.85 €** në programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike- **Mallra dhe shërbime** (kodi-130), fondi 10, shuma **7,689.85 €**.

Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike -**Mallra dhe Shërbime** (kodi 130) , fondi burimor 10.

Nga kategoria ekonomike -**Mallra dhe shërbime**, fondi 10, në kuadër të programit **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programi **Zjarrfikësit dhe inspektimet** (18422), kodi funksional (0320), shuma **1,000.00 €** të ri-alokohet në nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike-**Mallra dhe shërbime** (kodi-130), fondi 10, shuma **1,000.00 €**.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të Drejtorisë për **Financa, Ekonomi dhe Zhvillim**, për transfer të mjeteve financiare, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarje të mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve, pjesës të cilës nuk i është paguar dëmi nga vërshimet e ndodhura në vitin 2022.

-Drejtori për **Financa, Ekonomi dhe Zhvillim**, theksoi se pjesa më e madhe e të dëmtuarve nga vërshimet e vitit 2022 janë paguar, ndërsa pjesa e pa paguar të cilët do t'i kompensoi komuna kap vlerën rreth 14.000.00 euro, mund të jetë më pak ose më shumë, kjo do të vërtetohet në bazë të kalkulimit të listës të cilën do ta keni për seancë.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të Drejtorisë për **Financa, Ekonomi dhe Zhvillim**, për ndarje të mjeteve financiare për kompensimin e një pjese të dëmit nga vërshimet e vitit 2022, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Shtator-Tetor 2023,

Kërkesa 1.

Kërkesë nga shoqata e gjahtarëve “Dukagjini” Klinë, kërkojnë mbështetje financiare për rrethimin e rezervatit, pasi që siç theksojnë, bëjnë kultivimin e kafshëve të egra në rezervatin i cili gjendet në zonën e fshatit Dolle, shuma e kërkuar nga shoqata është 3 980 euro.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga shoqata e gjahtarëve “Dukagjini” Klinë, rekomandoi që parashtruesit të kërkesës t’i dërgohet ftesë për takim që të bisedohet çështja rreth kërkesës së parashtruar për mbështetje financiare dhe funksionimit të rezervatit në fjalë.

Kërkesa 2.

Kërkesë e parashtruar nga znj. Arjana Banushaj, e cila kërkon mbështetje financiare, pasi që vuan nga një sëmundje e rënd nga viti 2020, thekson se njëherë ka marr ndihmë nga komuna financiarisht por që me përkeqësimin e gjendjes shëndetësore, rriten shpenzimet dhe paraqitet nevoja për kërkesë të ndihmës financiare.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Arjana Banushaj për ndihmë financiare, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit dhe të diskutohet rreth kësaj kërkesë si dhe kërkesave të tjera të parashtruara për natyrën e njëjtë.

Kërkesa

3.

Kërkesë nga Ramë Pantina, përfaqësues i banorëve të fshatit Stapanic, për kalimin fizik dhe kadastral të parcelave, përkatësisht oborreve dhe të një pjese të tokave nga komuna e Malishevës, të kalojnë në regjistrat kadastral të komunës së Klinës, duke u bazuar në Ligin për Kufijtë Administrativ të Komunave Nr.08/L-041, përkatësisht në nenin 9, nenin 10, pika C, dhe nenin 11. Fshati Stapanic, si fshat është i ndarë në dy pjesë: njëra pjesë i takon komunës së Klinës dhe një pjesë i takon komunës së Malishevës. Pjesa që i takon komunës së Klinës në komunikimin juridik, administrativ, njihet me emrin Zabërgjë, ndërsa pjesa që i takon komunës së Malishevës, njihet me emrin Kijevë. Banorët e pjesës që i takojnë komunës së Klinës me dokumentacion civil, janë banorë legjitim të komunës së Klinës, mirëpo oborret dhe shtëpitë i kanë në territorin e komunës së Malishevës. Këta banorë, gjatë realizimit të shërbimeve të tyre në komunat përkatëse po kanë vështirësi në procedurat administrative për faktin se janë me dy komunat në rrafshin administrativ civil me komunën e Klinës, ndërsa në rrafshin kadastral me komunën e Malishevës. Këta banorë kërkojnë nga të dy komunat që me mirëkuptim reciprok dhe në konsultim me organet tjera shtetërore përkatëse, të vendosin lidhur me kërkesën e tyre që të ju aprovonjë këtë kërkesë dhe këtyre banorëve të ju lejohet kalimi nga njëra komunë në tjetrën, nga komuna e Malishevës të kalojnë në komunën e Klinës, pasi që ky fshat është i ndarë në dysh, njëra pjesë administrohet nga komuna e Malishevës e ndërsa pjesa tjetër administrohet nga komuna e Klinës. Me rastin e pranimit të kësaj kërkesë nga ana e banorëve, kërkojmë nga

komuna e Klinës dhe ajo e Malishevës që në një afat të arsyeshëm të marrin në konsideratë këtë kërkesë dhe të ju drejtohen organeve tjera shtetërore përkatëse, që këtyre banorëve të këtij lokaliteti të ju kthehet një përgjigje.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Ram Pantina përfaqësues i banorëve të fshatit Stapanic, për kalim kadastral të parcelave të cilat janë me komunën e Malishevës, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit, Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi si dhe në Zyrën Ligjore.

Pika 7. Të ndryshme.

Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që pik e rendit të ditës për seancën rregullt e cila do të mbahet në muajin tetor, të hyjë informimi rreth trajtimit të qenve endacakë.